

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6040
E enjte, 18 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria miraton ndryshimet buxhetore

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM HOTI

Pa ShBA-në, BE-ja s'mund t'i japë epilog dialogut Kosovë - Serbi



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka bërë me dije se roli i ShBA-së dhe BE-së në procesin e dialogut Kosovë - Serbi është komplementar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka shprehur optimizëm për një koordinim të

ngushtë në mes të këtyre dy aktorëve botërorë në këtë proces. Ai ka thënë se BE-ja nuk ka fuqi dhe nuk mund ta zgjidhë problemin Kosovë - Serbi pa mbështetjen e fuqishme të ShBA-së. Hoti e ka ftuar spektrin politik të Kosovës që të tregojë unitet në këtë proces ■ FAQE 4-5

OPINION

VETËM MARRËVESHJA QË PËRFSHINË RIPËRCAKTIMIN E KUFIJVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË DO TË ISHTE NJË MARRËVESHJE FINALE F. 8

Valon MURATI



DIÇKA NUK SHKON MË 27 QERSHORIN E SHTËPISË SË BARDHË F. 6

Denion NDRENIKA



AKTUALE

LAJÇAKU MERR MENDIMET E LIDERËVE PARTIAKË PËR PROCESIN E DIALOGUT ME SERBINË F. 2

EKONOMI

RUKIQI: PAKOJA EMERGJENTE TË IMPLEMENTOHET SA MË SHPEJT F. 9

26 PËR QIND E BUXHETIT TË ZKA-SË SHFRYTËZOHET PËR QIRA TË OBJEKTIT F. 9

KULTURË

"SOVRANITETI DHE LEGJITIMITETI I SHTETIT TË KOSOVËS" F. 13

Prof. Dr. Fehari RAMADANI



PAS RITJES SË RASTEVE ME COVID-19, INSTITUCIONET PUBLIKE DHE PRIVATE OBLIGOHEN TA REDUKTOJNË STAFIN

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka propozuar që të gjitha institucionet publike dhe private ta vazhdojnë punën me staf të reduktuar

dhe nga shtëpia pas shtimit të rasteve me Covid-19. Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që

t'i zbatojnë rekomandimet e dala nga ky institut, duke theksuar nevojën për bartje të maskave dhe mbajtjen e distancës prej 2 metrave

HOTIT I KËRKOHEM QË TË RAPORTOJË NË KUVEND PARA TAKIMIT NË SHBA

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepgisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pas rritjes së rasteve me Covid-19, institucionet publike dhe private obligohen ta shkurtojnë stafin e punonjësve

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka propozuar që të gjitha institucionet publike dhe private ta vazhdojnë punën me staf të shkurtuar dhe nga shtëpia, pas shtimit të rasteve me Covid-19. Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve t'i zbatojnë rekomandimet e dala nga ky institut, duke theksuar nevojën për bartje të maskave dhe për mbajtjen e distancës prej dy metrave

**EPOKA ERE**

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të gjitha institucionet publike dhe private të obligohen që ta organizojnë punën me stafin e tyre në distancë fizike apo nga shtëpia/online. Krejt kjo është bërë në funksion të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë bazuar në legjislacionin në fuqi. Vendimi obligon shtimin e kontrolleve rigorozë për bartjen e maskave të punëtorëve të çdo institucioni.

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka propozuar që të gjitha institucionet publike dhe private ta vazhdojnë punën me staf të shkurtuar dhe nga shtëpia, pas shtimit të rasteve me koronavirus. "Jo vetëm për shkak të urgjencës, por për shkak që MSh-ja në vazhdimësi është duke e mbikëqyrë situatën epidemiologjike, duke pasur parasysh se në javën e fundit kemi pasur një rritje në institucionet publike dhe

private, me qëllim të parandalimit, IKShPK-ja na ka rekomanduar që ta përkrahë vendimin që të gjitha institucionet publike dhe private obligohen që ta organizojnë punën në distancë fizike apo nga shtëpia e tyre, që nënkupton reduktim të stafit. Të gjitha institucionet obligohen t'i shtojnë kontrollet në hyrje të çdo institucioni. Të gjitha institucionet obligohen ta organizojnë punën në përputhje me manualin. Obligohen institucionet që t'i ndërmarrin vendimet sipas manualit. Ky vendim kërkoj që të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit", ka thënë Zemaj.

IKShPK-ja, qytetarëve: Bartni maska

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK) e ka konsideruar brengosëse rritjen e numrit të personave të infektuar me Covid-19 në Kosovë. Të martën ky institucion ka regjistruar 141 raste të infektimit me këtë virus

brenda 24 orëve.

Në një njoftim në rrjetin social "Facebook", ky Institut ka bërë thirrje për zbatim të rekomandimeve të tij, duke theksuar nevojën për bartje të maskave dhe mbajtjen e distancës prej dy metrave. "Këta numra të këtyre ditëve flasin shumëçka. Këta numra tregojnë përkeqësim të situatës epidemiologjike me rrezik të shkuarjes drejt humbjes së kontrollit si dhe drejt mbingarkimit, pastaj të institucioneve shëndetësore, gjegjësisht të Klinikës Infektive ku, fatkeqësisht, personat me sëmundje shoqëruese dhe të moshuarit mund të përfundojnë fatalisht", është thënë në reagim.

Mes të tjerash, ky Institut u ka kërkuar bizneseve dhe sektorit të gastronomisë që të veprojnë në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së në mënyrë që të pamundësohet përhapja e sëmundjes Covid-19. "Ne po shkojmë drejt një normaliteti të ri. Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të

mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të fafesisit, të komunitetit dhe pastaj të gjithë qytetarëve", është thënë në reagim të këtij Instituti.

IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve, bizneseve, gastronomëve, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave (këto dy javë), dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. "Duke marrë parasysh nevojat e

qytetarëve për shërbime shëndetësore, bëjmë apel te punëtorët shëndetësorë që t'iu përmbahen rekomandimeve të IKShPK-së për aplikimin e masave mbrojtëse duke ruajtur kështu shëndetin e tyre, të pacientëve dhe të gjithë qytetarëve të vendit. I rekomandojmë ShSKUK-së t'i përgjysmojë të gjitha shërbimet dhe ta ndalojë rreptësisht hyrjen e përcjellësve në reparte, shërbime specialiste dhe klinika", theksohet në reagimin e IKShPK-së.

Nga data 8 shkurt deri më 16 qershor janë testuar gjithsej 19 312 persona të dyshimtë me Covid-19 dhe prej tyre pozitivë kanë dalë gjithsej 1 756 raste, 968 raste të shëruara, me gjithsej 34 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese.

Qeveria miraton ndryshimet buxhetore

EPOKA ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar ndryshimet e propozuara për ndarjen buxhetore për vitin 2020. Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, në prezantimin e ndryshimeve, ka thënë se sfida e pandemisë ka detyruar ndryshime dhe rishikim të buxhetit për të adresuar këtë çështje. Sipas saj, nuk është larguar asnjë projekt fillestar dhe se kursimet do të kthehen në proceset e ardhshme buxhetore. "Sa i përket implikimeve buxhetore, jam e vetëdijshme se secili prej nesh do të dëshironim që të kemi më shumë fonde që të dalim nga kjo sfidë dhe ta rimëkëmbim ekonominë. Të hyrat buxhetore në vitin 2020 në total janë mbi 1 miliard e 788 milionë euro dhe presim një rënie prej 5 përqindësh. Me



kthimin e rritjes ekonomike presim që në 2021-n të kemi edhe rritje të të hyrave. Shpenzimet buxhetore presim që të jenë 2 miliardë e 620

milionë euro. Deficiti i buxhetit pritet të jetë 6.5 për qind e bruto produktit vendor", ka thënë ajo.

Ndërsa kryeministri Avdullah

Hoti ka thënë se kjo punë është bërë falë bashkëpunimit ndërministror. "Unë edhe një herë ju falënderoj për bashkëpunim dhe koordinimin

me Ministrinë e Financave. Janë marrë obligimet e nevojshme që këto çështje të adresohen me kohë. Ne marrim obligime që t'i paguajmë të gjitha faturat që janë në përputhje me ligjin", ka thënë Hoti, duke bërë me dije se fondi për rimëkëmbjen ekonomike do të fillojë të implementohet menjëherë. "Fondi 350 milionë euro, pra fondi për rimëkëmbje ekonomike, do të implementohet menjëherë në ditët e ardhshme në bashkëpunim me odat dhe aktorët e tjerë që merren me këtë çështje", ka thënë Hoti.

Në anën tjetër, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, ka thënë se kjo ministri nuk ka buxhet për menaxhimin e pandemisë. "Kemi një minus prej 20 milionë eurove për skemën pensionale dhe minus 14 milionë euro për situatën me Covid-19", ka thënë Reçica.

Lajçaku merr mendimet e liderëve partiakë për procesin e dialogut me Serbinë

Në ditën e dytë të vizitës në Prishtinë, i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka takuar kryetarët e partive politike. Në takimet e ndara që ka pasur Lajçak me liderët e partive politike, ka diskutuar rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi



njoftimi, Lajçaku ka vlerësuar se roli konstruktiv i LDK-së në procesin e dialogut është shumë i rëndësishëm. I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian (BE) për

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka bërë me dije se AAK-ja ia ka prezantuar Lajçakut pozicionin e saj për një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë, e cila duhet të rezultojë me njohje reciproke. “Në takim me të dërguarin e posaçëm të BE-së, Miroslav Lajçak, prezantuar përkushtimin e AAK-së për procesin e dialogut dhe qëndrimin e pandryshuar për arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese, e cila duhet të rezultojë me njohje reciproke në kufijtë ekzistues. Roli aktiv i ShBA-së në dialog, për të cilin ka qenë i zëshëm dhe këmbëngulës në vazhdimësi kryetari Haradinaj, ka rritur shpresat se dialogu Kosovë - Serbi, i zgatur për një dekadë do të finalizohet me njohje reciproke në kufijtë ekzistues. Për shkak të qëndrimeve të ndryshme përbrenda BE-së në lidhje me ndryshimin e territoreve, ka ndodhur një lëkundje e besimit. Megjithatë, Aleanca përshëndet angazhimin e BE-së në dialog, nën udhëheqje të ShBA-së. Në

kuadër të takimit, ritheksuam se BE-ja, para së gjithash, pas plotësimit të të gjitha kriterëve, Kosovës do t'i japë një vendim të shpejtë për heqjen e regjimit të vizave”, ka thënë Selimi. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, pas takimit me emisarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, ka thënë se kanë diskutuar për krijimin e parakushteve për rifillimin e dialogut dhe mundësinë e liberalizimit të vizave për Kosovën. “Ne sot patëm takim me Lajçakun. Ai shpallosi idenë dhe angazhimin e tij për dialogun Kosovë - Serbi dhe krijimin e parakushteve për të rifilluar dialogu. Temë ka qenë edhe liberalizimi i vizave. Kërkuam që personalisht të angazhohet që Kosova sa më shpejt ta marrë liberalizimin e vizave dhe tani e tutje besoj se do të kemi takime të rregullta Prishtinë - Bruksel edhe me palët e interesuara që të fillojë dialogu”, ka thënë Limaj. Një ditë më herët Lajçaku është takuar edhe me presidentin Hashim Thaçi, kryetaren e Kuvendit Vjosa Osmani dhe kryeministrin Avdullah Hoti.


EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 QERSHOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, në ditën e dytë të vizitës së tij në Prishtinë, ka zhvilluar një takim me liderët e partive politike. Ai është takuar me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, me atë të Lidhjes Demokratike të

Brukseli po punon për rifillimin e dialogut i cili pritet të nisë në muajin që vjen”, theksohet në njoftimin e LV-së.

Po në këtë njoftim është thënë se Kurti nënvizoi se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është i nevojshëm. “Dialogu duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, larg nga marrëveshjet sekrete për shkëmbim territorial dhe me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të



Kosovës, Isa Mustafa, përfaqësues të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe me kryetarin e Nismës Socialdemokrate Fatmir Limaj. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, së bashku me nënkryetarin Besnik Bislimi, deputeten dhe anëtarin e kryesisë Fitore Pacolli-Dalipi dhe anëtarin e kryesisë, Glauk Konjufca, kanë takuar Lajçakun, i cili ishte i shoqëruar edhe nga shefja e zyrës së BE-së, Natalia Apostolova. Lajçaku gjatë takimit ka theksuar interesimin e Brukselit për dialog me parime e marrëveshje për normalizim midis dy vendeve. “Z. Lajçak u shpreh se nuk mund të ketë marrëveshje të suksesshme pa përfshirjen e kryetarit Albin Kurti dhe Lëvizjen Vetëvendosje, duke marrë parasysh përkrahjen gjithnjë në rritje dhe ndikimin e madh brenda vendit. Ai njoftoi se

Bashkuara të Amerikës. Dialogu duhet të udhëhiqet nga përfaqësues legalë dhe legjitim e jo nga këta që kanë kontrabanduar pushtetin duke rrëzuar qeverinë e mirë dhe demokratike të zgjedhur nga populli. Prandaj, zgjedhjet janë të domosdoshme dhe të pashmangshme për një qeveri legjitime e kredibile të dialogojë dhe të arrijë një marrëveshje të qëndrueshme e afatgjatë”, citohet të ketë thënë Kurti. Edhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi dhe Çështje të Tjera Rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajçak. “Mustafa e njoftoi Lajçakin për qëndrimet e LDK-së për procesin e dialogut dhe se LDK-ja është e interesuar që marrëveshja të mbyllet me njohje reciproke”, theksohet në njoftimin e LDK-së. Sipas këtij

dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në vizitën zyrtare në Prishtinë është takuar edhe me përfaqësuesit e AAK-së të cilët janë pjesë e qeverisë.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, AFRIM HOTI

PA SHBA-në, BE-ja S'MUND T'I JAPË



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka bërë me dije se roli i ShBA-së dhe BE-së në procesin e dialogut Kosovë - Serbi është komplementar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka shprehur optimizëm për një koordinim të ngushtë në mes të këtyre dy aktorëve botërorë në këtë proces. Ai ka thënë se BE-ja nuk ka fuqi dhe nuk mund ta zgjidhë problemin Kosovë - Serbi pa mbështetjen e fuqishme të ShBA-së. Hoti e ka ftuar spektrin politik të Kosovës që të tregojë unitet në këtë proces

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka deklaruar se ShBA-ja dhe BE-ja nuk janë në garë në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, i cili do të rifillojë së shpejti. Ai ka bërë me dije se ShBA-ja dhe BE-ja kanë koordinim të ngushtë për këtë çështje.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka vlerësuar se çështjen e Kosovës BE-ja nuk mund ta zgjidhë pa ndihmën e fuqishme të ShBA-së. “Mendoj se roli i BE-së dhe

ShBA-së në këtë proces është komplementar. BE-ja definitivisht nuk mund ta zgjedhë këtë problematikë pa mbështetjen amerikane. Bile në rastin e Kosovës, BE-ja është aktore me kredibilitet të humbur për faktin se ka udhëhequr një proces shumë sensitiv, në shumë raste edhe me gabime të bëra nga lidhshipi i Kosovës”, ka thënë Hoti.

Ai ka treguar arsyet pse BE-ja e ka bërë veten aktore të pabesueshme në këtë proces. “Fatkeqësisht, BE-ja asnjëherë nuk i ka dhënë asnjë lloj mbështetje Kosovës, përveç

mbështetjes financiare që u është dhënë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke e lënë kështu Kosovën të vetmin shtet me regjim të vizave. Pra, nëse flasim për problematika kaq të thjeshta, atëherë vërtet është e pabesueshme që BE-ja do të ketë fuqi për t'i dhënë epilog përfundimtar dialogut Kosovë - Serbi”, është shprehur ai. Sipas Hotit, serioziteti dhe efikasiteti i ShBA-së në këtë proces është parë në arritjen e tri marrëveshjeve të fundit ndemjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e ambasadorit Grenell. Ai ka ftuar spektrin politik të

Kosovës që të tregojë unitet dhe përgjegjshmëri në këtë proces. “Mendoj se është momenti i fundit që të gjithë të tregojnë përgjegjshmëri në këtë proces. Nuk është çështje e zgjedhjes së tyre, por çështje e obligimit kombëtar për të përmbyllur këtë proces. E kundërta do të na ballafaqonte me situata të pakëndshme dhe me atë që ne e njohim si kompromis të vazhdueshëm”, ka thënë Hoti.

“Epoka e re”: Z. Hoti, pas krijimit të kushteve për rifillim të dialogut, BE-ja dhe ShBA-ja kanë filluar përgatitjet për takimet mes palëve. Si e shihni rolin e ShBA-së dhe të BE-së në këtë proces?

Hoti: Nuk ka dilema se tani po flasim për një dinamikë të përshtypshme të këtij procesi dhe një momentum të ri, i cili është trumbetuar tash e sa kohë. Rrethanat e këtij momentum pa dyshim i ka krijuar qeveria e z. Haradinaj, me vendosjen e tarifës ndaj

mallrave serbe, e cila, pos të tjerash, ka krijuar rrethana të reja në kuptimin e ngritjes së vetëdijes ndërkombëtare që problemit të Kosovës t'i jepet një drejtim. Ndërsa tani heqja e tarifës dhe reciprocitetit definitivisht shënon një etapë të re në këtë proces, e cila është marrë shumë seriozisht nga dy aktorët globalë. Serbia dhe Kosova dëshirojnë të jenë pjesë e BE-së dhe çfarëdo zgjidhje në mes tyre duhet të kalojë përmes mekanizmave të BE-së. Mirëpo një zgjidhje e tillë nuk mund të bëhet pa një mbështetje të fuqishme, pa një plan, pa një strategji të detajuar, mbrapa të cilit qëndron ShBA-ja, në krye me presidentin Trump dhe të dërguarin e tij, z. Grenell.

“Epoka e re”: Është fituar një përshtypje se nuk po shihet një koordinim në mes të ShBA-së dhe BE-së për këtë proces. Mund të kemi një proces të pakoordinuar në mes të këtyre aktorëve?

Hoti: Në dukje mbase mund të

EPILOG DIALOGUT KOSOVË - SERBI

së dhe të BE-së për ta përmbyllur këtë proces.

“Epoka e re”: Pra, nuk shihni ndonjë garë në mes të ShBA-së dhe BE-së për këtë proces se kush do të tregohet më i suksesshëm?

Hoti: Mendoj se roli i BE-së dhe i ShBA-së në këtë proces është komplementar. BE-ja nuk mund ta zgjidhë këtë problematikë pa mbështetjen amerikane. Bile në rastin e Kosovës, BE-ja është aktore me kredibilitet të humbur për faktin se ka udhëhequr një proces shumë sensitiv, në shumë raste edhe me gabime të bëra nga liderhipi i Kosovës. Fatkeqësisht, BE-ja asnjëherë nuk i ka dhënë asnjë lloj mbështetje Kosovës, përveç mbështetjes financiare që u është dhënë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke e lënë kështu Kosovën të vetmin shtetet me regjim të vizave. Pra, nëse flasim për problematika kaq të thjeshta, atëherë vërtet është e pabesueshme që BE-ja do të ketë fuqi për t’i dhënë epilog përfundimtar dialogut Kosovë - Serbi.

Në këtë drejtim, një mbështetje e fuqishme amerikane është më se e nevojshme dhe kjo tashmë është dëshmuar përmes marrëveshjeve që janë nënshkruar deri më tani, marrëveshje këto të nënshkruara në mënyrë shumë të përshtetshme dhe efikase. E kam fjalën për tri marrëveshjet e fundit të arritura me ndërmjetësimin e ambasadorit Grenelli. Kjo qasje amerikane nuk është kuptuar drejt vetëm nga Kosova, por edhe nga liderhipi serb, i cili po e merr këtë çështje në mënyrë serioze. Dy aktorët kryesorë globalë janë të kyçur në proces dhe sigurisht se në fund do të ketë diçka serioze.

“Epoka e re”: Cila duhet të jetë qasja e liderhipit institucional dhe atij politik në Kosovë ndaj këtij procesi?

Hoti: Vendet e vogla si Kosova asnjëherë gjatë historisë e as sot nuk e kanë komoditetin e zgjedhjes. Ne nuk jemi faktor përcaktues dhe, nëse nuk jemi të tillë, atëherë duhet të bëhemi faktor bashkëpunues. Historia jonë është e lidhur ngushtë me ShBA-në dhe asnjë zgjidhje nuk do të ishte kredibile dhe e besueshme nëse prapa saj nuk qëndron fuqishëm aleatja jonë kryesore, ShBA-ja. Këtu do të ishte për keqardhje nëse një pjesë e

pushtetit apo pjesë të caktuara të opozitës të bënin ndarje të tilla mes BE-së dhe ShBA-së. Ne duhet ta përshëndesim iniciativën e fuqishme amerikane për ta përmbyllur këtë proces.

Nëse në krah të kësaj iniciative vendoset edhe BE-ja, me shpresë se kësaj here do të jetë vërtet serioze, atëherë mendoj se po flasim për zhvillime interesante dhe për një momentum i cili duhet të shfrytëzohet.

“Epoka e re”: Në bazë të kësaj që po thoni i bie se i gjithë

spektri politik duhet të marrë përgjegjësi në këtë proces?

Hoti: Mendoj se është çasti i fundit që të gjithë të tregojnë përgjegjshmëri në këtë proces. Nuk është çështje e zgjedhjes së tyre, por çështje e obligimit kombëtar për ta përmbyllur këtë proces. E kundërta do të na ballafaqonte me situata të pakëndshme dhe me atë që ne e njohim si kompromis të vazhdueshëm. Keni parë se Kosova në secilin stad të negociatave që ka marrë pjesë, ka thënë se, ‘meqenëse po e hapim edhe këtë kapitull, atëherë sigurisht se na pret

edhe një kompromis tjetër në raport me Serbinë’. Të gjitha këto kanë ardhur si rrjedhojë e mungesës së unitetit politik për t’i thënë një herë e përfundimisht fund kësaj qasje. Sot ne nuk kemi çka flasim për kompromise. Mund të flasim vetëm për njohje reciproke, me aranzhime të caktuara politike dhe juridike për minoritetet në Kosovë. Tani nuk mund të flitet për aranzhime që do ta cenonin direkt ose indirekt sovranitetin apo integritetin e Kosovës. Dhe kjo mund të arrihet vetëm nëse kemi pozitë dhe opozitë të bashkuar dhe me një zë.

Haradinaj - Stublla merr përkrahje nga Kosnetti për vetingun diplomatik

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka mbajtur një videokonferencë me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, me të cilin ka biseduar për gjendjen aktuale në këtë ministri si dhe për prioritetet e saj, duke përfshirë vetingun diplomatik. Haradinaj-Stublla ka shtuar se lidhja strategjike e Kosovës me ShBA-në është e fortë dhe e përhershme dhe vendi ynë me krenari i përket botës së udhëhequr nga Amerika. E njoftova ambasadorin Kosnett për gjendjen e gjetur në

MPJD, për vizionin dhe prioritetet politike e funksionale, për të cilat gjeta mbështetje nga ana e tij, sidomos në reformën e planifikuar të Shërbimit të Jashtëm që do të realizohet përmes projektit të vetingut diplomatik. U pajtuam që ta thellojmë dhe fuqizojmë bashkëpunimin bilateral, sidomos në koordinimin dhe përafrimin e objektivave të politikës së jashtme, me theks të veçantë ndërtimin e bashkëpunimit me mekanizmat e NATO-s”, ka shkruar Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në “Facebook”.



kemi një përfytyrim se po flasim për dy procese të ndara, por në bërthamën e këtij procesi mendoj e kemi një koordinim të ngushtë në mes të BE-së dhe ShBA-së. Dëshëm apo nuk deshëm ta pranojnë, BE-ja është edhe formalisht lehtësuese e procesit të negociatave dhe, siç dihet, kjo është bërë tashmë një parakusht formal për të dyja vendet për ecjen e tyre në rrugën e anëtarësimit në BE. Mirëpo për shkak të pozicionit paska të brishtë të BE-së, ndihma e ShBA-së në këtë proces është e pakontestueshme. Një vendosmëri e administratës aktuale për t’i dhënë fund një herë e përfundimisht këtij procesi, mendoj se është kuptuar seriozisht edhe nga Brukseli. Në këtë drejtim mendoj se po flasim për veprime të dy aktorëve, të cilët synojnë një përfundim të përbashkët të këtij procesi. Pra, besoj fuqishëm se kemi koordinim të ngushtë të ShBA-

Zemaj kërkon që të respektohen masat mbrojtëse dhe parandaluese kundër Covid-19

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se mosrespektimi i distancës fizike dhe sociale dhe masave parandaluese të rekomanduara nga IKShPK-ja, mosmbajtja e maskave dhe dorezave, ditët e fundit ka rezultuar me rritje të numrit të të infektuarve. "Kjo situatë është krijuar sidomos pas

datës 30 maj kur u lehtësuan masat. Çdokush duhet jetë i vetëdijshëm se virusi vërsulet e shpërndahet në tubime e grumbullime njerëzish dhe përmes kontakteve. Në këto rrethana është e pamundur mbikëqyrja e përgjithshme. E vetmja armë e jona kundër këtij virusi është ruajtja e distancës fizike e sociale dhe respektimi i masave mbro-

jtëse dhe parandaluese", ka thënë Zemaj të mërkurën. Ai ka shtuar se të gjitha institucionet publike dhe private duhet t'i ndërmarrin të gjitha veprimet që dalin nga udhëzimet e "Manualit për mbrojtjen nga përhapja e virusit Covid-19". "Tubimet dhe grumbullimet e njerëzve janë bërë rreziku më i madh", është shprehur Zemaj.



Diçka nuk shkon më 27 qershorin e Shtëpisë së Bardhë



Denion NDRENIKA

Ka diçka madhore që nuk shkon në dialogun e shqiptarëve me serbët referuar takimit të pritshëm në Shtëpinë e Bardhë në mes të Kosovës dhe Serbisë: kushtet në pabarazi. Për palën tonë kërkohej heqja e taksës dhe mandej reciprociteti. E në atë kohë serbëve nuk u kërkohej gjë. Tash kur e hoqëm edhe taksën edhe reciprocitetin, na kushtëzohet të mos kërkojmë anëtarësim në organizmat ndërkombëtarë, ndërkaq serbëve që të ndalin fushatën kundër njohjeve dhe çnjohjeve, ndonëse ata vazhdojnë të festojnë siç postoi ministri i Jashtëm, Ivica Daçiç, pas Algerisë.

Veç kësaj, temë qenka ekonomia kur themeli i dialogut është politik (marrëdhëniet), ushtarak (marrëveshja e Kumanovës ku Serbia është pala humbëse e luftës) dhe ligjor me të drejtën ndërkombëtare (GjND, edhe pse jo vendim detyrues). E në fund të kthehemi në status quo nëse më 27 qershor në Shtëpinë

e Bardhë në Uashington nuk do të ketë përparim!

I kam shprehur pikëpamjet fare qartë edhe asokohe, madje edhe në gazetën "Politika +" që hapa me kolegun Bledar Kuka vetëm për luftën për çlirimin e atdheut tonë. Sepse Kosova është territori i Shqipërisë verilindore, pra atdheu ynë.

Me një rikthim të para fillimit të bombardimeve, Rambujeja përcaktoi mundësinë e një konference ndërkombëtare për Kosovën tri vjet më pas duke përfshirë, ndonëse pa përmendur fjalën "referendum", shprehjen e vullnetit të popullit. Vjena ishte jo aq me rëndësi sepse raporti i Kai Aides i hapi udhën UNOSEK-ut të drejtuar nga Marti Ahtisari.

Kam qenë kundër idesë së ministrit të Jashtëm, Besnik Mustafaj, për pavarësi të kushtëzuar dhe pa dyshim se po edhe kundër tezës përçarëse dhe përjashtuese për Shqipërinë "aktor, por jo faktor". Besnik Mustafaj dhe askush tjetër nuk ka asnjë autoritet që t'i shkelë vendimet e Prizrenit, veçanërisht të Vlorës. Edhe Bujanit më 1943-1944 madje si akti pasues.

Pavarësia e Shqipërisë u shpall pikërisht nga të gjithë trevat e saj për shtetin e 28 nëntorit 1912 e kësaj vetëm Shqipëria ka të drejtë të flasë për çdo kënd e tokë, për popullin e saj të ndarë. Jam shumë i sigurt se nuk do të

keqpërdoret pa u lexuar çka shkruaj e assesi të keqpërdoret pasi nuk është gjetur asgjë që të bjerë ndesh me rrugën ku po ecet sot.

E kam thënë dhe rithem: shumëkush mendon që pavarësia dhe shtetformimi i krahinës më të rëndësishme verilindore që solli ndarjen e Shqipërisë nga Perandoria Turke, Kosovës, na çon në bashkim.

Unë them dhe mbroj idenë se ne nuk kemi bërë kurrë asnjë akt kombëtar që ta hedhë poshtë bashkimin e vendosur në Prizren dhe në Vlorë.

Unë vetëm shpreh pikëpamjen mbi çfarë është kërkuar dhe çfarë thotë ambasadori Riçard Grenell. Vetëm qyqarët mund të mveshin terma idiotë për, kinse, antiamerikanizëm për

të shprehur një pikëpamje.

Më duket se ato që thotë ai janë tejkaluar që nga Rambujeja, Parisi, Kumanova, Vjena, GjND-ja. Pra, asnjë fjalë më shumë nuk po them nga pikëpamjet e mia që janë të mbështetura vetëm në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878 dhe Kuvendin e Vlorës 1912.

Andaj dua të mësoj të drejtën ose jo për saktësisht çfarë na kërkojnë ne dhe serbëve. Këtu nuk ka aspak vend për të thënë nëse na do ose jo Amerika apo si silllet Amerika me investimin e saj. Thjesht, ta di nëse duket e drejtë çfarë referoj unë dhe jo çfarë mendoj unë që rrjedh veç nga Prizreni dhe Vlorë.

Pra, vërehen pabarazi në kërkesat-kushte për Kosovën krahasuar me Serbinë për dialogun?

Nisur nga zhvillimet prej së paku Rambujesë, mos ka barazi në këto kërkesa-kushte mes kolonialistëve serbë ushtrues gjenocidi, shfarosjeje, masakrash ndaj palës sonë?

Luftën e fituam ne shqiptarët dhe aleatët. Aleksandër Vuçiqi është humbës. Moti nuk duhej të lejonim që humbësi të barazohet me ne që u masakruam.

Serbëve nuk iu kërkua ndonjëherë të tregojnë ku i kanë groposur shqiptarët e masakruar, në ç'vend i hodhën dhe as t'i dorëzojnë kriminelët e tyre.

E në fund një rikthim: përse ka kërkesa për ne kur ne nuk kemi bërë asgjë kundër serbëve?! Po pse ekonomia e para kur është politike, ushtarake, ligjore?!



Vendimi për Darko Tasiqin merret më 22 qershor



PRISHTINË, 17 QERSHOR - Të hënën, më 22 qershor, pritet të merret vendimi për Darko Tasiqin, i akuzuar për krime lufte kundër popullatës civile shqiptare. Në seancën e mbajtur të mërkurën prokurorja speciale e Kosovës, Drita Hajdari dhe dy mbrojtësit e Tasiqit, Lubomir Pantoviq dhe Dejan Vasiq, kanë paraqitur fjalën e tyre përfundimtare. Derisa po mbahet seanca, afër objektit të Gjykatës Themelore të

Prizrenit kanë protestuar banorë të fshatit Krushë e Vogël.

Disa gra të Krushës së Vogël, që bashkë me shumë anëtarë të familjes u mblodhën para gjykatës, kërkuan dënim maksimal për Tasiqin.

Darko Tasiq, i cili deri në vitin 1999 kishte jetuar në Krushë të Vogël, bashkë me familjen e tij, akuzohet nga Prokuroria Speciale e Kosovës për krime të luftës kundër popullatës civile shqiptare.

Në këtë gjykim ka dëshmuar edhe gazetari britanik John Sweeney, i cili ka bërë dokumentarin "Serb genocide against Albanians" - "Gjenocidi serb kundër shqiptarëve". Ai kishte rrëfyer për masakrën në fshatin Krushë e Vogël, në gjykimin ndaj serbit të akuzuar Tasiq. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, gjatë konfliktit të viteve 1998-'99 në Kosovë janë vrarë më shumë se 13 500 persona. (Rel)

Hoti: Nuk ka kompromise të tjera, Kosova shkon në dialog vetëm për njohje

Sa i përket takimit të paralajmëruar për datën 27 qershor në Uashington, kryeministri Avdullah Hoti ka thënë të mërkurën se ende nuk ka agjendë apo tema të përcaktuara, ndërsa ka pohuar që pas qartësimit të tyre do të caktohet edhe delegacioni që do të marrë pjesë në takim. Hoti ka bërë me dije se nuk do të ketë kompromise të tjera. Sipas tij, Kosova shkon në dialog vetëm për njohje

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të mërkurën tryezën e diskutimit "Cila është platforma e Qeverisë së Kosovës në dialogun me Serbinë?" midis kryeministrit Hoti dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe mediave.

Në hapjen e tryezës, Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, ka theksuar se procesi i dialogut ka ndikuar në mënyrë indirekte në zhvillimet politike.

Kryeziu ka shtuar se duke qenë se dialogu tashmë ka të bëjë me konsolidimin e shtetësisë, si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm, konsensusi politik është i domosdoshëm.

Ambasadori i Zvicrës në Prishtinë, Jean Hubert-Lebet, në fjalën e tij përshëndetëse ka theksuar se procesi i normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë është çështje evropiane. Sipas tij, "secili duhet ta kuptojë se problemet evropiane kërkojnë zgjidhje

evropiane. [...] Vetëm zgjidhjet që i respektojnë vlerat evropiane mund të shpijnë në integritet evropiane".

Në adresimin e tij, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, listoi parimet dhe objektivat e Platformës së Qeverisë së Kosovës lidhur me procesin e dialogut. Sa i përket takimit të paralajmëruar për datën 27 qershor në Uashington, kryeministri ka thënë se ende nuk ka agjendë apo tema të përcaktuara, ndërsa ka pohuar se pas qartësimit të tyre do të caktohet edhe delegacioni që do të marrë pjesë në takim. Hoti ka thënë se në këtë proces nuk do të ketë kompromise të tjera. Sipas tij, Kosova shkon në dialog vetëm për njohje.

Për më shumë, ai njoftoi se qeveria ka marrë vendim që deri në mbajtjen e këtij takimi t'i pezullojë veprimet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, duke treguar vullnetin e mirë të

palës së Kosovës. "Pas përfundimit të këtij takimi, në muajin korrik pritet të mbahet edhe Samiti i Parisit" njoftoi ai. Lidhur me rolin e ShBA-së dhe BE-së në procesin aktual të dialogut, Hoti ka thënë se të dyja palët e kompletojnë njëra-tjetrën. Sipas tij, marrëveshja nuk mund të arrihet, aq më pak të zbatohet pa përfshirjen e dy palëve.

Kryeministri Hoti ka thënë se ka mandat që të negociojë mbi bazën e Kushtetutës dhe ajo i jep autorizime të qarta që ta udhëheqë këtë proces. "Edhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e bën edhe më të qartë, në detaje i tregon kompetencat e mia në procesin e dialogut, të cilat kompetenca as nuk dua, as nuk mund t'i transferoj tek dikush tjetër, e as nuk do të lejoj që dikush tjetër të ndërhyjë në kompetencat e mia. Po besoj se kjo nuk ka nevojë as të thuhet realisht pasi për aq kohë sa Kushtetuta është e qartë

nuk kemi pse të bregosemi për këtë çështje", ka deklaruar Hoti. Më tej, kryeministri Hoti ka pohuar se parimi mbi të cilin ne do ta vendosim këtë proces është: E para, integriteti territorial i Kosovës është i panegociueshëm. "Unë nuk kam mandat që ta hap këtë temë në procesin e dialogut. E dyta, karakteri unitar i shtetit të Kosovës. Unë nuk kam mandat që të bisedojmë për këtë çështje. Dhe, parimi i tretë, marrëveshja duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës", u shpreh kryeministri Hoti. Pjesëmarrësit e pranishëm nga shoqëria civile në këtë tryezë ngritën çështjet e formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, përfshirjen e komunitetit serb në procesin e dialogut, perspektivën gjinore në dialog, si dhe shfuqizimin e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Ky diskutim u organizua me përkrahjen e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.



Hotit i kërkohet që të raportojë në Kuvend para takimit në ShBA

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që të kërkojë nga kryeministri i Kosovës Avdullah Hoti, që të raportojë para deputetëve për çështjen e dialogut me Serbinë. Madje raportimi, sipas kryetares së Kuvendit, Vjosa Osmani, duhet të ndodhë para se Hoti të nisët për në Shtetet e Bashkuara dhe se, sipas saj, kryeministri duhet të

debattojë dhe raportojë para deputetëve lidhur me qëndrimet që do t'i mbajë Republika e Kosovës. "Me vendim unanim të anëtarëve të pranishëm të kryesisë unë do t'i drejtohem kryeministrit të vendit, që ai t'i raportojë Kuvendit para se të nisët për Uashington, për takimin e datës 27 (qershor), duke pasur gjithnjë parasysh rëndësinë e

çështjes së dialogut dhe duke pasur parasysh rolin mbikëqyrës që duhet ta luajë Kuvendi dhe, po ashtu, detyrimin që e ka qeveria që t'i raportojë Kuvendit për çështje të politikës së jashtme", ka thënë Osmani pas mbledhjes së Kryesisë.

Osmani ka thënë se data e këtij raportimi do të vendoset në ditën në vijim por, sipas saj, duhet të

ndodhë para udhëtimit në Uashington.

Kryetarja e Kuvendit, Osmani, ka treguar se në mbledhjen e kryesisë është vendosur që të martën të mbahen dy seanca plenare, ku do të diskutohet edhe kërkesa për interpelancë për kryeministrin Hoti.

Ky i fundit pritet të udhëtojë për në ShBA më 27 qershor për të

marrë pjesë në takimin në Shtëpinë e Bardhë. Në këtë takim, të thirrur nga i dërguari i posaçëm i ShBA-së për negociatat e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, pritet të takohen përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë. Në këtë takim Kosovën pritet që ta përfaqësojnë kryeministri Avdullah Hoti dhe presidenti Hashim Thaçi.

Vetëm marrëveshja që përfshinë ripërcaktimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ishte një marrëveshje finale

Nuk e kam as dyshimin më të vogël se në rrethanat aktuale dhe mundësitë reale që na janë krijuar, funksionaliteti i shtetit të Kosovës dhe fuqizimi i sovranitetit të saj kalon përmes Kosovës Lindore dhe dialogut me Serbinë. Hapja e rrugës për një kushtetutë të re do të ndodhë vetëm pasi ta realizojmë një marrëveshje të re me Serbinë, një marrëveshje ndërkombëtare e cila do ta shtrojë rrugën për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë kalon përmes Kosovës Lindore dhe dialogut me Serbinë.



Valon MURATI

1. Kosova, ndonëse e shpall pavarësinë në vitin 2008, nuk u njoh nga Serbia dhe nga një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare, mbi të gjitha nga Rusia, Kina si dhe pesë shtetet e Bashkimit Evropian: Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qiproja. Konsolidimi i pavarësisë në arenën ndërkombëtare, sidomos anëtarësimi i saj në OKB dhe në BE, kalon përmes votës apo së paku abstenimit të këtyre shteteve që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Rrjedhimisht, që nga viti 2011 filloi një dialog fillimisht teknik, e më pas edhe politik në mes të Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja. Ideja ishte që të krijoheshin kushtet që përmes një dialogu me Serbinë të njiheshin Kosova dhe të krijoheshin kushtet që edhe vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës ta njohin atë. Sidoqoftë, qasja e dialogut ka qenë e padrejtë dhe pala e Kosovës shumë pak apo aspak ka ndikuar që kjo qasje të ndryshojë. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është zhvilluar vetëm për Kosovën, serbët në Kosovë dhe rrjedhimisht akomodimin shtesë të tyre në Kosovë. U arritën shumë marrëveshje, disa prej të cilave, si ajo e krijimit të Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë, nuk ka arritur ende të implementohet. Kosova ka elemente të jofunksionalitetit edhe me këtë kushtetutë për shkak të privilegjeve kushtetuese që kanë serbët (e tek të cilët në këto rrethana ndikon Serbia). Shtimi i strukturave të tjera administrative brenda organizimit të saj të brendshëm vetëm sa do ta rëndonin funksionimin e saj. Në anën tjetër shqiptarët në Kosovën Lindore dhe pozita e tyre fare nuk janë trajtuar në këtë dialog. Dhe ky ishte që nga fillimi një gabim

strategjik i palës së Kosovës.

2. Kosova është shtet i pavarur dhe në këtë drejtim çështja me Serbinë është e mbyllur. Sidoqoftë disa çështje të marrëdhënieve kanë mbetur të pazgjidhura. Problemet themelore në mes të dy vendeve ishin dhe mbeten për t'u zgjidhur çështja e tri komunave në veriun e Kosovës si dhe ajo e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës që gjenden nën Serbi. Lëvizja për Bashkim që në fillim ka menduar se Kosova me Serbinë kanë probleme politike dhe jo teknike andaj edhe duhet që bisedimet të jenë politike. Në këtë funksion është kërkuar që në bisedimet me Serbinë të shtrohet edhe çështja e shqiptarëve të Kosovës Lindore dhe kjo çështje të zgjidhet fillimisht përmes zbatimit të parimit të reciprocitetit në të drejta me serbët në veriun e vendit. Është konstatuar se ky parim duhet të shkojë deri aty sa zgjidhja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë ripërcaktimi i kufijve në mes të dy vendeve duke u bazuar në të drejtën për vetëvendosje të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë dhe të serbëve në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Kjo e drejtë duhet t'u takojë të dy popujve në këto vise aty ku janë shumicë dhe kanë vazhdimësi territoriale, shqiptarët me Kosovën dhe serbët me Serbinë. Një zgjidhje e tillë jemi të bindur se do të ishte zgjidhja më e drejtë e problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e rrjedhimisht do të ishte edhe përfundimi i konfliktit shqiptaro-serb. Me këtë rast do të krijoheshin kushtet që Kosova përfundimisht të funksionalizohet si shtet, t'i hiqte nga qafa kufizimet që i ka në Kushtetutën e saj si trashëgimi e Pakos së Ahtisaarit, përfshirë privilegjet kushtetuese për serbët për ta bllokuar çfarëdo ndryshimi kushtetues në Kosovë. Vetëm me një marrëveshje të re me Serbinë, e cila do ta përfshinte edhe ripërcaktimin e kufijve, do të krijoheshin rrethanat për funksionalizimin e plotë të shtetit të Kosovës në tërë territorin e vet. Rrjedhimisht do

të mundësohej ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës në funksion të krijimit të kushteve për përcaktimin e vullnetit të popullit të Kosovës për raportin me Republikën e Shqipërisë: union, federatë, konfederatë, bashkim klasik, pavarësi me raporte speciale me të apo pavarësi e plotë për Kosovën. Për këtë qëllim Lëvizja për Bashkim që në vitin 2010 e ka hartuar Platformën Politike për Zgjidhjen Përfundimtare të Çështjes Shqiptaro-Serbe (shih në <https://levizjaperbashkim.org/assets/docs/platforma-politike-per-zgjidhjen-perfundimtare-te-ceshtjes-shqiptaro-serbe-shqip.pdf>).

3. Përndryshe, sot kushdo që proklamon bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, pa treguar rrugën e ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës, e cila e ndalon bashkimin dhe të cilën nuk mund ta ndryshosh pa votën e deputetëve serbë, qëndron në pozita populiste. Qëndron në këto pozita sepse këtë synim madhor kombëtar e përdor vetëm si parullë politike për konsum politik ditor e elektoral. Nuk e kam as dyshimin më të vogël se në rrethanat aktuale dhe mundësitë reale që na u kanë krijuar funksionaliteti i shtetit të Kosovës dhe fuqizimi i sovranitetit të saj kalon përmes Kosovës Lindore dhe dialogut me Serbinë. Hapja e rrugës për një kushtetutë të re do të ndodhë vetëm pasi ta realizojmë një marrëveshje të re me Serbinë, një marrëveshje ndërkombëtare e cila do ta shtrojë rrugën për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë kalon përmes Kosovës Lindore dhe dialogut me Serbinë. Një marrëveshje e tillë do të krijojë kushtet edhe për rënien e agjendave populiste në botën shqiptare, agjendave të "mëdha kombëtare", agjendave që kanë përherë Serbinë në rend dite dhe rrjedhimisht do të krijohen kushtet për një politikë ndryshe dhe politikanë të tjerë. Do të vinin në rend të ditës politikanët normalë. Atëherë vërtet mund të flasin për përqendrim në luftën kundër korrupsionit, sundimin e ligjit dhe të zhvillimit ekonomik. Përndryshe me agjendën e Serbisë të papërfunduar, çdoherë do të mbesim viktimë e politikave populiste në Kosovë, por edhe në vetë Kosovën Lindore. Në anën tjetër ashtu siç kemi ne nevojë të çlirohemi nga tema e Serbisë, ashtu Serbia përfundimisht ka nevojë të çlirohet nga Kosova. Kjo është e domosdoshme të ndodhë nëse Serbia dëshiron të fillojë të frymojë lirshëm si një demokraci e konsoliduar. Çlirimi nga Kosova dhe çështja shqiptare është testi i demokracisë serbe. Duke qenë në

rrethana të tilla, te dy popujt dhe shtetet tona nuk duhet ta lëshojmë mundësinë e një marrëveshjeje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë.

4. Deri në vitin 2018 nuk dukej se kishte rrethana ndërkombëtare për t'u hapur çështja e ripërcaktimit të kufijve. Andaj insistimi i palës shqiptare në atë fazë do të duhej të përqendrohej në kërkimin e të drejtave të barabarta për shqiptarët e Kosovës Lindore si ato të serbëve në veriun e Kosovës. Mirëpo në vitin 2018 politika amerikane dhe ajo e një pjese të shteteve evropiane hapi mundësitë që nëse palët kanë vullnet politik kjo temë do të mund të hapej. Kjo ishte një mundësi e artë që nuk duhej lëshuar. Fatkeqësisht, ndodhi ajo që personalisht nuk do ta besoja asnjëherë. Duke qenë se u duk se bartës i këtij procesi do të jetë presidenti Thaçi, klasa politike në Prishtinë, shoqëria civile dhe mediat iu kundërvunë në unison. Ishte më shumë një betejë kundër Thaçit sesa kundër idesë, por dëmi u bë. Ideja u godit duke bërë që ne të humbim një mundësi të artë për t'u futur në bisedime me Serbinë në një moment kur amerikanët kishin interesim të madh ta kryenin këtë proces. Ne injoruar deri edhe letrën e presidentit Trump për çështjen e bisedimeve. Interesi i amerikanëve ishte i qartë: përmes zgjidhjes së problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë ata e largonin ndikimin rus nga rajoni, qoftë nga Serbia, qoftë nga Kosova dhe kështu krijonin kushte që Serbisë t'i hapej rruga e integriteteve evropiane, ndërsa Kosovës rruga e legjitimitetit ndërkombëtar dhe e integriteteve euroatlantike. Edhe sot e kësaj dite kundërshtarët e idesë përveç parullave romantiko-folkloristike nuk kanë dalë me ndonjë argument racional pse janë kundër një projekti të tillë politik.

5. Që nga fillimi politika jonë është sjell me dialogun thujtë atë po e bëjmë nga zori sepse po na e kërkojnë miqtë e jo pse është i rëndësishëm edhe për ne, për funksionalitetin e shtetit të Kosovës dhe hapjen e rrugës për përparim e zhvillim të qytetarëve të saj. Kjo qasje ka bërë që në vend se të punohet për një konsensus politik për dialogun, ai të shfrytëzohet për betejën e brendshme politike. Kjo betejë e brendshme politike, dhe qasja refuzuese ndaj dialogut realisht ka rrezuar dy qeveritë e fundit të Kosovës. Edhe qeveria aktuale një ndër detyrat kryesore do ta ketë dialogun me Serbinë. Por edhe tek kjo qeveri si tek ato parapraket në qasjen ndaj dialogut spikat refuzimi ndaj mundësisë që ata e quajnë "shkëmbim i territoreve". Në anën tjetër kjo qasje është e rrezikshme, sepse përveç që në njëherë anë është një grumbull

pikash refuzuese e vijash të kuqe, në anën tjetër krejt besimin në rezultatet e dialogut e ka bartur tek amerikanët e evropianët, por pa ofruar një qasje pro aktive dhe platformë që do të ofronte zgjidhje konkrete të problemeve e jo fontanë dëshirash. Të gjithë e dinë se në dialog do të ketë kompromise, ndërsa politikanët tanë publikun e përgatisin për rezultate maksimale. Do të shkojmë në bisedime thonë e nuk do të lëshojmë asgjë pe dhe do ta marrim njohjen nga Serbia. Në anën tjetër duke parë vendosmërinë amerikane për një zgjidhje politike, dhe qëndrimin tonë pa ndonjë projekt politik që ofron rrugëzgjidhje por refuzues në idenë e ripërcaktimit të kufijve, atëherë ka rrezik se mund të na ofrohet një marrëveshje e cila vërtet mund të ketë brenda këta kufij të Kosovës, por njëkohësisht mund të ketë një autonomi politiko-territoriale për Kosovën e cila do ta bënte Kosovën krejtësisht jo-funksionale. Andaj që të mos arrijmë në pozitën kur ne do të refuzojmë propozimet e aleatëve tanë, e Serbia mund t'i pranojë dhe të vendoset në një pozitë shumë më të favorshme politike, dhe t'i hapet rruga e integriteteve evropiane pa marrë parasysh se a e nënshkruajmë ne apo jo marrëveshjen, politika shqiptare do të duhej që të jetë më pro aktive dhe më e hapur ndaj mundësisë së idesë së ripërcaktimit të kufijve. Vetëm marrëveshja që përfshin ripërcaktimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ishte një marrëveshje finale. Çdo marrëveshje e cila do të përfshinte një autonomi për serbët në Kosovë, qoftë përmes një asociacioni me kompetenca ekzekutive, qoftë përmes një autonomi politiko-territoriale, por edhe qoftë nëse mbetet kjo status-quo, nuk do të jenë zgjidhje përfundimtare në mes të dy vendeve dhe dy popujve. Marrëveshje të tilla do ta kenë të vështirë implementimin dhe nëse implementohen do ta dëmtojnë rëndë funksionimin e Kosovës dhe interesin kombëtar. Mund të vije puna që pas disa vitesh edhe ta kërkojmë ripërcaktimin e kufijve, por atëherë Serbia mund të na vij deri në Ibër dhe ne ta humbim mundësinë të marrim Kosovën Lindore, sepse deri atëherë nuk do të mbeten shqiptarë atje. Kjo do të ishte një papërgjegjësi e madhe e brezit tonë për brezat e ardhshëm. Por personalisht kam besim se edhe interesi amerikan është që të kemi një zgjidhje përfundimtare të konfliktit shqiptaro-serb përmes ripërcaktimit të kufijve dhe që ky interes amerikan gradualisht do të bëjë që edhe politika jonë të reflektojë dhe që përfundimisht të vetëdijësohet për rëndësinë e momentit.

Guvernatori i BQK-së ofron përkrahje për sektorin e sigurimeve

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të mërkurën në takim udhëheqësen e sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim

Ekonomik, Lindita Daija, si dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, të udhëhequr nga Sami Mazreku, me ç'rast është diskutua lidhur me gjendjen e sektorit të sigurimeve në Kosovë, i cili ka qenë ndër sektorët më të

prekur nga situata e krijuar për shkak të pandemisë Covid-19. Guvernatori Mehmeti ka shprehur gatishmërinë e BQK-së për përkrahje të sektorit të sigurimeve dhe ndërmarrjen e të gjithë masave të nevojshme me qëllim të ruajtjes së sta-

bilitetit të këtij sektori. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës falënderuan guvernatorin Mehmeti për angazhimin e pakursyer në



mënyrë që sektori i sigurimeve të vazhdojë të performojë në mënyrë pozitive.

26 për qind e buxhetit të ZKA-së shfrytëzohet për qira të objektit

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Komisioni për Buxhet dhe Transfere, kryesuar nga Hekuran Murati, kryetar, ka shqyrtuar të mërkurën raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2019. Raportin financiar vjetor të ZKA para anëtarëve të Komisionit e ka prezantuar dhe arsyetuar Auditori i Përgjithshëm Besnik Osmani.

Ai përveç se ka arsyetuar të gjitha shpenzimet e buxhetit për këtë institucion, ka shprehur brengën se 26 për qind të buxhetit të ZKA-së shfrytëzohet për qira të objektit ku aktualisht janë vendosur. "ZKA vitin e kaluar ka pasur 2.9 milionë euro, ku 78 për qind janë shpenzuar për paga dhe mëditje, 22 për qind për mallra dhe shërbime, ndërsa të tjerat për shpenzime kapitale. Problem i

vazhdueshëm mbetet pagesa për qira pasi në ende operojmë nëpër ndërtesa private", ka thënë Osmani.

Ai ka treguar se ka pasur edhe rritje të numrit të auditimeve.

Edhe për deputetët shqetësuese ishte mungesa e objektit, ndërsa kërkuan nga MBP dhe MAP që sa më shpejt të bëhet një zgjidhje për sistemimin e ZKA-së si një institucion i rëndësishëm shtetëror në një objekt qeveritar.

Raporti financiar i ZKA-së mori miratimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Transfere dhe i njëjti bashkë me rekomandime do të dërgohet për miratim në seancë të Kuvendit.

Komisioni për Buxhet dhe Transfere, po ashtu, ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2019. Raportin vjetor para deputetëve e kanë prezantuar përfaqësues



nga KRPP-ja, ndërsa u janë përgjigjur edhe pyetjeve të anëtarëve të komisionit. Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2019 u përkrah nga të

gjithë anëtarët e komisionit. Komisioni për Buxhet dhe Transfere ka shqyrtuar edhe raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit të cilin e ka prezantuar kryetari i OShP-

së, Blerim Dina.

Raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2019 është miratuar me shumicë votash nga Komisioni për Buxhet dhe Transfere.

Rukiqi: Pakoja Emergjente të implementohet sa më shpejt



PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se Pakoja Emergjente e qeverisë duhet të implementohet sa më shpejtë që është e mundur dhe që rishikimi i buxhetit të bëhet në afatet më të shpejta. Sipas Rukiqit, shumica e bizneseve nuk po arrijnë të qarkullojnë më shumë sesa 50 për qind në krahasim me planifikimet e tyre apo edhe me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Rukiqi, gjithashtu, ka shtuar se

për sektorët të cilët po përballen me rënie drastike të qarkullimit, duhet t'iu mundësohet riprogramimi i kredive, të bazuara në aftësitë paguese që kanë. "Pakoja emergjente, nëse mund të quhet emergjente, duhet të implementohet sa më shpejt që është e mundur, prandaj rishikimi i buxhetit duhet të bëhet në afatet më të shpejta. Gjithashtu, për sektorët që vazhdojnë të përballohen me rënie drastike të qarkullimit duhet të mundësohet

riprogramimi i kredive konform aftësisë paguese që e kanë. Shumica e bizneseve në vend nuk po arrijnë të qarkullojnë më shumë se 50 për qind në raport me planifikimet, apo periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Çdo skenar parasheh së paku 5 për qind tkurrje ekonomike. Pakoja e rimëkëmbjes është shpresa dhe rrugëdalja e vetme nga një 'kataklizëm' i mundshëm ekonomik me pasoja të pariparueshme për dekada të tëra", ka deklaruar Rukiqi.

Arrihet marrëveshja për hapjen e korridorit ajror Shqipëri - Kosovë

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Albcontrol dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigimit Ajror e Kosovës, kanë nënshkruar të mërkurën një letër-marrëveshje për koordinimin e trafikut ajror ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës. Marrëveshja është lidhur në

kuadër të projektit "Mbledhja për Normalizimin e Aviacionit të Ballkanit" (BANM) të udhëhequr nga NATO. "Ky është një hap i rëndësishëm për normalizimin e hapësirës ajrore të Kosovës sepse korridori i ri ajror do t'i shkurtojë për rreth 15 minuta

fluturimet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari' dhe, si rrjedhojë, do t'i rrisë përfitimet e udhëtarëve, do t'i ulë kostot operacionale të kompanive ajrore dhe emitimet e karbonit drejt një aviacioni më të gjelbër. Me

këtë rast, ASHNA falënderon të gjithë partnerët, në veçanti autoritetet e NATO-s dhe KFOR-in, që kanë lehtësuar këtë arritje dhe vazhdojnë ta përkrahin zhvillimin e aviacionit civil në Kosovë", theksohet në njoftimin e ASHNA-s.



Ndërron jetë aktivisti i Nismës Albert Krasniqi, Limaj ngushëllon familjen

Si pasojë e një aksidenti ka ndërruar jetë aktivisti i Nismës Socialdemokrate, Albert Krasniqi.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj ka ngushëlluar familjen Krasniqi, duke theksuar se ikja e hershme e Albertit ka lënë boshllëk të madh.

“Lajm i kobshëm vdekja

tragjike e të riut nga Tërpeza e Malishevës, Albert Krasniqi. I prekur thellë me humbjen e jetës në mënyrë tragjike të bashkëvendësit tim, aktivistit të përkushtuar të Nismës Albert Krasniqi”,

“Ikja e hershme e Albertit ka lënë boshllëk të madh tek ne. Albertin e kam takuar disa orë para aksidentit në selinë e

Nismës Socialdemokrate si gjithnjë energjik dhe i gatshëm për sfida të reja”, ka shkruar Limaj.

Lideri i Nismës ka pohuar se Alberti do të mbetet përherë në kujtesën tonë si djalë i edukuar dhe i përgatitur profesionalisht, por mbi të gjitha si një djalë me vlera të larta njerëzore.



Bahtiri mbështet protestën kundër rritjes së rasteve të dhunës seksuale në Mitrovicë



MITROVICË, 17 QERSHOR (ER) - “Vajzat e Mitrovicës” kanë organizuar të mërkurën një protestë paqësore pas dhunës dhe ngacmimeve seksuale që kanë ndodhur gjatë muajve të fundit në qytetin e Mitrovicës. Kësaj proteste i është bashkuar edhe kryetari i kësaj komune, Agim Bahtiri, i cili ka përkrahur iniciativën dhe protestën e organizuar kundër kësaj dukurie negative

në këtë qytet. Me këtë rast, kryetari Bahtiri në fjalën e tij ka theksuar se i mbështet dhe do të jetë pjesëmarrës çdoherë kur organizohen aktivitete të tilla që kanë për qëllim eliminimin e dukurive negative në qytetin e Mitrovicës, veçmas ndaj ngacmimeve seksuale të cilat duhet ta marrin dënimin e merituar nga organet e rendit dhe ligjit.

Gjithashtu, kryetari Bahtiri ka bërë me dije se për këto dukuri që kanë ndodhur ka reaguar menjëherë përmes institucioneve përgjegjëse, duke u përkujdesur që kryerësve të këtyre veprave t’u shqiptohet dënimi i merituar. Vlen të potencohet se kjo protestë ka filluar para objektit të Komunës së Mitrovicës, duke vazhduar te gjykata dhe ka zgjatuar përafërsisht një orë.

Fabrika “Myfixmask” brenda 24 orëve prodhon 350 mijë maska

MALISHEVË, 17 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka vizituar fabrikën për prodhimin e maskave “Myfixmask” në fshatin Bellanicë me pronar Naser Hoxha.

Pronari i “Myfixmask”-it, Naser Hoxha, ka njoftuar kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me punësimin e punëtorëve që janë nga Bellanica dhe fshatrat e tjera të kësaj komune, që numri i përgjithshëm është rreth 150 punëtorë.

Ai, po ashtu, e ka njoftuar Begajin për prodhimin e maskave nga

kjo fabrikë, e cila brenda 24 orëve prodhon 350 mijë maska. Hoxha ka treguar se maskat prodhohen për tregun vendor dhe atë evropian (Gjermani, Zvicër dhe Francë). Ai, ndër të tjera, ka kërkuar nga Begaj dhe qeveria në qendër mbështetje që t’ua lehtësojë tregun në konkurrencë me prodhimet e jashtme. Pronari i kësaj fabrike ka thënë se në një të ardhme të afërme do t’i rrisin kapacitetet e prodhimit, por edhe të punësimit. Fabrika “Myfixmask” i ka dhënë komunës një donacion prej 5 000 maskash.



Ndërkaq kryetari Begaj gjatë vizitës në këtë fabrikë ka thënë se “Myfixmask” është një tregues i mirë i zhvillimit ekonomik. “Brenda mundësive ligjore dhe potencialeve tona si komunë do t’ju mbështesim, por shfrytëzoj rastin t’i bëjë thirrje qeverisë qendrore që t’ia kthejë Zonën Ekonomike Malishevës, sepse ajo zonë do të krijonte mundësi të mëdha për investitorë të shumtë nga mërgata jonë, e cila është e interesuar për investime në vendlindje”, është shprehur Begaj.

Haziri kërkon që të respektohen masat kundër Covid-19

Gjilan, 17 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, pas takimit që ka mbajtur në Shtabin për menaxhimin dhe parandalimin e virusit Covid-19, ka paraqitur masat të cilat janë ndërmarrë sot me qëllim të efikasitetit edhe më të madh në kontrollin e situatës. Ai ka potencuar të mërkurën se është bërë vlerësimi i gjendjes në 24 orët e fundit, ku kanë ndërmarrë pakon e re të masave që duhet të respektohen nga qytetarët, punëtorët e shtetit në të gjithë sektorët, pastaj punëtorët dhe bizneset, institucionet fetare dhe organizimet shoqërore etj., për



parandalimin e virusit dhe gjendja të jetë e menaxhueshme.

“Ka një rikthim të lehtë të infeksionit në Komunën e Gjilanit

dhe për këtë kemi aktivizuar pakon e re të masave. Kjo ka ardhur për shkak të pëlcitjes së rasteve në komunat fqinje dhe në vetë kryeqendrën e Kosovës, prandaj bazuar në këtë ne kemi ndërmarrë hapat në funksion të ruajtjes së shëndetit publik dhe mbrojtjes së qytetarëve nga infeksioni i mundshëm apo përhapja e tij më tutje. Në Komunën e Gjilanit janë 25 të infektuar aktivë, në 12 burime të infeksionit, praktikisht në 12 shtëpi. Konfirmohet nga ekipet shëndetësore se janë me simptoma të lehta. Deri më tani Gjilani ka 98 raste në total që

kanë rezultuar pozitivë në gjithë fazën e përballjes me pandeminë, 71 të shëruar plotësisht, derisa dy kanë vdekur”, ka thënë kryetari Haziri.

Ai ka njoftuar se janë 76 mostra për testim, duke përfshirë edhe ato të ditës së djeshme dhe janë në pritje të rezultateve nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik për ta pasqyruar gjendjen reale me Covid-19.

Haziri ka bërë thirrje për kujdes maksimal në daljet nga shtëpia, në distancën sociale, në masat mbrojtëse dhe në respektim të vendimit për pakon e re të masave.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (9)

KTHIMI TE MENGJESI I 5 MARSIT...

**Bedri ISLAMI**

Në këtë truall u lindën Rifati, Hamza dhe Ademi. Shumë shpejt, jo çuditërisht, shumë shpejt do të vinte koha e tyre, do të vinte momenti kur ata të ndienin mbi vete peshën e dhunës. Do ta shihnin fillimisht tek i ati i tyre, mësuesi Shaban Jashari, që nuk lejohej të jepte mësim sepse ishte i lëçitur, i lëçitur dy herë, nga pushteti dhe, si rrjedhojë e tij, edhe nga njerëzit. Do të vinte koha e ngushticës kur portat e kullave të tyre do të hapeshin rrallëherë për miq e dashamirë; kur dyer të tjera do të quheshin të mbyllura për to; kur nuk do ta kishin pjesën e tyre në gëzimet e dasmave e të fejesave; kur do të fillonin ta ndienin vetminë, por nuk do t'i përkulte vetnia. Do të kishte momente kur regjimi zgjaste kulaçin, "bëjuni urë e jona dhe jua shtrajmë si të doni", por ajo ishte një urë ku nuk kishte kaluar kurrë asnjë nga fisi i Jasharëve dhe pas saj vinte menjëherë kërbaci i rëndë i dhunës serbe, dëbimi nga puna, arrestimi, ngufatja nëpër burgjet serbe, ngujimi në shtëpi sipas urdhrat të policisë, tatimet e njëpasnjëshme, pastaj përsëri arrestimet dhe, në fakt, në treqind vite, thuhet asnjëri nga burrat e djemtë e këtij fisi nuk qëndroi jashtë burgjeve të dhunës. Njëkohësisht, asnjëri prej tyre nuk u ndje i thyer dhe nuk kishte përse.

Ishte një fillësë e zakonshme për Prekazin dhe në të njëjtën kohë për Drenicën. Diku ndjehej më shumë, diku ndjehej më pak, dikush ishte i huaj, i ftohtë dhe i largët me pushtetin, do të kishte edhe fillësë marrëveshesh, që nuk zgjasnin shumë dhe që asnjëherë nuk do të ishin në gjirin e këtij Fisi. Jasharët hynin tek njerëzit dhe familjet që i kishin përherë marrëdhëniet e ftohta, të huaja dhe të largëta me pushtetin serb ose me serbishtet e tyre. Nuk do të ndjenin kurrë, në asnjë moment, keqardhje pse i kishin ngritur kështu këto marrëdhënie, në të kundërtën, do të ndjeheshin mirë. Ata nuk do të përpiqen kurrë t'i lehtësojnë marrëdhëniet e ngurta dhe të hidhëta me pushtetin, megjithëse e dinë se, pas çdo refuzimi, do të kishte shtypje më të madhe. Në të vërtetë ata e kishin të vetën devizën e të atit të tyre, Shabanit, se "Ma mirë me hekë e me u flijua vetë, sesa me marrë në qafë shumë njerëz të tjerë". Ideja e flijimit ishte e hershme, askush

nuk duhej të çuditëj që ajo do të vinte krejt natyrshëm disa dekada më vonë dhe në ato përmasa që dihen.

Nëse u larguan gjithnjë e më shumë e u bënë të huaj me pushtetin, Jasharët u lidhën me shumë me tokën dhe me bukën. Nëse do të lëçiteshin nga pushteti, ata do të ishin të afërt me punën. Nuk e kishin ndërprerë kurrë atë, e kishin menduar se do të kishin dhunë e egërsi mbi Familjen e tyre, por kishin menduar po ashtu se, duhej të kishte një rrugë mbijetese, e natyrshëm do të vinte nga djersa që do të derdhnin. Gjithë ditën nëpër arat e bashtinat e familjes, në darkë, në dhomën e burrave, djemtë e rinj do të dëgjonin të vërtetën për Shaban Polluzhën, për shkaku pse i ishte bashkëngjitur prej fillimit Shaban Jashari radhëve të tij, bisedohet se çka e bën të fortë Kosovën dhe "pasha ditët kur kena kenë Shqipni".

Kjo është fillësia, e cila kalon pashmangshëm përmes katër këndeve, traditës së stërgjyshërve, tokës ku kanë lindur e ku e kanë në mend të vdesin, mësimeve të babait të tyre, Shabanit dhe mësimit që duhet t'i lënë fëmijëve të tyre.

Asgjë tjetër nuk është më e rëndësishme për to, për asgjë në botë nuk do të heqin dorë prej tyre, dhe, kur të vijë momenti, do të dëshmojnë se kishin pasur vetëm një gabim në përlogaritjen e tyre: mësimi që do të kishin dashur të lënë për fëmijët e tyre ishte rritur në përmasa të pallogaritshme, ishte bërë mësim për të gjithë njerëzit që e duan vendin e tyre. Nuk ishin nisur të bënin kaq shumë, ata si në baladat e lashta, ishin nisur të bënin pjesë të detyrës së tyre për Kosovën, kurse në të vërtetë, krejt natyrshëm, ishin bërë shumë më tepër se kaq.

Kthimi te mëngjesi i 5 marsit...

Kishte filluar të agonte dhe nuk dukej asgjë e jashtëzakonshme. Ishte një fillim marsi, ndoshta si çdo ditë tjetër e këtij muaji, në të cilin pranvera ndahet nga dimri. Gjithë natën, dy djem të Fisit, Bashkimi dhe Aliu, kishin bërë roje. Ngrica e bardhë dukej ende si shtrëngë përmbi fushat dhe vendet përreth mbartnin qetësinë e zakonshme të mëngjesit. Kishte kaluar ora pesë dhe njerëzit kishin filluar të zgjoheshin. Në oborret e brendshme të shtëpive lëvizte qetësisht Hamza, gjithnjë me ndjenjën e mirë të të qenit në shtëpi. Ishte në netët e rralla kur ndodhte një gjë e tillë. Tetë vite

ilegalitet i kishin larguar me shtëpinë, por i kishte afruar me njerëzit e saj. Pas pak do të dukej tymi i magjeve të bukës dhe do të ishte një ditë si gjithë të tjerat.

Iku shkurti i dimrave, hyri marsi i lustrave.

Nuk do të ishte një mars i zakonshëm dhe këtë e tregonte një mitraloz i vendosur në një pikë të shtëpisë. Nipi dhe mixha, Bashkimi dhe Hamza, po bisedonin me njëri tjetrin, kur nga oda doli Ademi dhe u tha qetësisht, tepër qetësisht, si të ishte fjala për diçka që ishte pritur prej kohe se forcat serbe po rrethojnë Llaushën. Kishte qenë një telefonatë nga lagja e re e Skenderajt. Dikush i kishte thënë se i kishin parë forcat serbe duke ardhur nga Llausha. Shkoi drejt Hamzës, qëndroi pranë tij



dhe i tregoi për atë që i kishin thënë. Tjetri e shikoi qetësisht, ndezi edhe një cigare tjetër, këtij mëngjesi po i shijonte më shume se herët e tjera dhe i tha se "Për hajër na qoftë, ne kemi vendosur kështu dhe nuk ka rrugë tjetër. Për besë, nuk ka rrugë tjetër", - shtoi pas pak dhe bëri të futej brenda.

"Bëni gati disa armë se po shkojmë në Llaushë", tha Ademi dhe njerëzit u vunë në lëvizje. Pas pak erdhi një telefonatë tjetër, kujton nipi i tij, Bashkimi, dhe u thanë se forcat serbe nuk po shkojnë në Llaushë, por drejt Açarëve. Nuk kishte ndërruar asgjë në qëndrimin e tyre, nuk do të shkonin në Llaushë, por në Açarëve. Ishte rritur harta e sulmit të pritshëm të forcave serbe, kjo do të thoshte se ishte rritur harta e rezistencës. Telefonata tjetër do të përmbysë rendin e gjërave, por jo qëndrimin ndaj tyre. "Forcat serbe po vijnë drejt jush, drejt Prekazit".

Tani nuk kishin përse të lëviznin. Tani u duhej të zgjidhnin dy rrugë, ose të iknin, ose të qëndronin. Ndoshta kushdo do të mund të kishte vënë para vetes këtë pikëpyetje, të ikësh për të ardhur përsëri, apo të qëndrosh. Do të ishte në fund të fundit një pyetje e zakonshme për çdo njeri të zakonshëm. Megjithatë nuk ndodh kështu. Nga oda, ky po bëhej gati të merrte rrugë drejt luftës, në Llaushë apo në Açarëve qoftë ajo, vjen një kumt i ri, krejt i thjeshtë dhe krejt i kuptueshëm: "Djem, zini pozicionet se na e paskan mësyer neve".

Kaq, vetëm kaq dhe asgjë tjetër. Zgjimi i 5 marsit do të bëhej përmes tri telefonatave, por në mes të tria do të kemi të njëjtin qëndrim, duke ndërruar vetëm vendndodhjen e rendit të gjërave. Fillimisht është Llausha, pastaj Açarëva, pastaj Prekazi. Kështu ka ndodhur rendi i gjërave dhe kështu u është përgjigjur ai. Më saktë, kështu i janë përgjigjur ata, të Familjes dhe të Fisit.

A kishin mundësi të iknin? Sigurisht që po, për deri sa po bëheshin gati të merrnin rrugën për Llaushë ose për në Açarëve. Ata po shkonin drejt luftës, kudo që të ishte ajo, lufta po vinte drejt tyre. Përse nuk ikën dhe të riktheheshin në një ditë tjetër? Përse, në orët e para të mëngjesit, përmes agut të 5 marsit, që sapo kishte filluar të zbardhte, nuk morën rrugën e ikjes gratë, pleqtë, fëmijët?

Do të kthehem më pas në përgjigjen e kësaj pyetje, por një gjë duhet sqaruar që në luftë, për secilin për pjesëtarët e familjes, cilindo, do të ishte e mjaftueshme vetëm një thirrje e qetë, krejt e zakonshme, "djema, bëhuni gati se na e paskan mësyer neve", ndërsa për t'i hequr prej aty, me të mirë apo me përkëdheli, me forcë apo me urdhër, do të duhej shumë më tepër se një fjali e zakonshme. Ndoshta ky ishte i vetmi rast kur pinjollët e rinj të Familjes nuk i bindeshin të parëve të tyre. Si thashë, do të kthehem më pas në përgjigjen e këtyre dy pyetjeve, të cilat janë bërë atyre ditëve, janë bërë më vonë dhe nuk bëhen më.

Në mëngjesin e 5 marsit nuk kishte kohë për përgjigje të tilla. Ishte momenti kur secili që e dinte vendin e tij, do të shkonte drejt atij pozicioni, kur Familja do të shumëfishohej nga Fisi, kur një lagje, ajo e Jasharëve do të dukej sikur ishte e bashkërrëthuar edhe me lagjet e tjera të Prekazit të Poshtëm. Askush nuk e dinte se ky do të ishte 5 marsi i kthimit të së vërtetës në legjendë. Rrethimi po

bëhej i plotë, i trefishtë, i zjarrtë dhe i hekurt. Që prej dekadash nuk ishte parë një rrethim i tillë në Kosovë.

Njerëzit në kullat dhe në odat e burrave po prisnin. Përtej kthesës së parë, aty ku rruga merr në të djathtë drejt Skenderajt, u dukën tanket e para. Megjithëse ishte agu i ditës, ata dukeshin edhe më zinj se herët e tjera. Pastaj tanket e tjerë filluan të dalin edhe në anën e kundërt të shtëpive dhe drejt pozicioneve që kishin zënë dy nga djemtë më të rinj të shtëpisë, Besimi dhe Fitimi.

Njerëzit, sidomos në Shqipërinë londineze, që janë mësuar të dëgjojnë për Ademin e Hamzën, do të ishte e natyrshme të pyesin se kush janë këto të dy, Besimi dhe Fitimi. Mund të themi vetëm kaq se, të dy nuk i kishin kaluar të 14 vitet dhe se kjo që po fillonte, pas 22 janarit të të njëjtut vit, do të ishte beteja e dytë e jetës së tyre. Tanka u ndal përballë pozicionit të tyre dhe ngriti tytën e gjatë dhe të hekurt. Të dy djemtë u përulën mbi mitraloz dhe nga pozicioni që kishin zënë në qoshe e një objekti, filluan të qëllonin. Filluan të gjuajnë të parët, pasi forcat serbe ishin afruar shumë. Kishin detyrën të mbulonin pjesën kah fabrika e Municionit, sipërfaqen e sipërme prej nga policët dhe paramilitarët serbë po tentonin të afroreshin.

Ishin krismat e para të asaj lufte... I kishin nisur dy djem, trembëdhjetë dhe katërmëdhjetëvjeçarë. Krismat filluan të dëgjohej deri larg. Ishte një ushtimë që kishte filluar të zgjaste një ditë, një natë, përsëri ditën tjetër dhe natën tjetër, edhe një herë në ditën e tretë...

Dëgjohej në të gjitha viset përreth, herë pas here ajo shkante shumë përtej Prekazit dhe Drenicës... së bashku me dëgjimin e ushtimave lindi edhe pyetja, kush po lufton...

Fillimisht, se kush po lufton e dinin ata që ishin krah tij, sepse ishin të një llogoreje (tani flitej për llogore lufte), pastaj, më tej e dinin bashkëluftëtarët e tij disi më tutje, të cilët, me gjithë përpjekjet nuk do të arrinin t'i vinin në ndihmë përmes një rrethimi të trefishtë; tepër shpejt do të fillohej të bëhej i njohur fakti se cilët ishin rrethuar dhe ku po vazhdonte lufta në tri ditë e dy net, emri i Drenicës, edhe një herë po bëhej i kahdoshëm, pastaj vëmendja u përqendrua tek nocioni i një fshati, po ashtu me emër, Prekazi i Poshtëm, për t'u ndalur në simbolin e gjithë asaj që po ndodhte, Adem Jashari. Lufta kishte nisur prej kohe, ajo kishte kërkuar një Prijës, ai ishte gjendur, tani po kërkonte një Mit, ai po vinte, do të donte edhe një Legjendë, ajo po ngjizej brenda pak çasteve. Mrekullisht, Prijësi, Miti dhe Legjenda do të ishin në një emër. (Vijon)

ShBA-ja zgjeron sanksionet kundër Sirisë dhe mbështetësve të saj

UASHINGTON, 17 QERSHOR - Sanksionet e reja amerikane, në ekonominë e shkatërruar të Sirisë, kanë nisur së zbatuari më 17 qershor, në tentim të mohimit të presidentit sirian, Bashar al-Assad dhe mbështetësve të tij, ndonjë përfitim të mundshëm nga fitoret ushtarake.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian veçse kanë sanksionuar Sirinë, mirëpo masat e fundit nga Uashingtoni janë zgjeruar me qëllim të ndëshkimit të secilit individ, institucion apo kompani që kryen biznese me Damaskun. Projektligji me sanksione të reja mund të përdoret për t'i shënjestruar mbështetësit kyç të Assadit: Rusinë, Iranin dhe grupin militant të Libanit, Hezbollah.

Por, ky dokument do të ketë ndikim edhe te lojtarët rajonalë siç janë Jordania, Libani, Iraku dhe shtetet e Gjirit Arab, që synojnë të arrijnë pajtueshmëri me Sirinë, e cila tenton të rindërtohet pas nëntë vjetëve të luftës civile shkatërruese.

Ambasadorja amerikane në Kombet e Bashkuara, Kelly Craft, i ka thënë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, se sanksionet janë të menduara për "të privuar regjimin e Assadit nga mbështetja dhe të ardhurat, që ka shfrytëzuar për të kryer mizori të shkallës së lartë dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut, të cilat parandalojnë arrijtjen e një rezolute politike si dhe dëmtojnë

perspektivat për paqe".

Craft ka thënë se Assad duhet të zbatojë një rezolutë të Këshillit të Sigurimit, që bën thirrje për paqe, zgjedhje dhe tranzicion politik, bashkë me rinisjen e bisedimeve të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara. "Regjimi i Assadit duhet të marrë një vendim të qartë: ta ndjekë rrugën politike, të krijuar nga Rezoluta 2254, në të kundërtën i lë Shtetet e Bashkuara pa zgjidhje tjetër, përveçse ta vazhdojnë pezullimin e fondeve për rindërtim dhe vendosjen e sanksioneve kundër regjimit dhe mbështetësve të tij financiarë", ka thënë Craft.

Projektligji me sanksione, që është miratuar nga Kongresi amerikan në dhjetor të vitit të kaluar, mban emrin e një ish-fotografi të ushtrisë siriane, i cili ka ikur më 2014 nga Siria, bashkë me 55 000 imazhe që tregojnë brutalitetin nëpër burgjet e Assadit, prej kur ai ka nisur shtypjen e protestave më 2011. Qeveria siriane ka fituar kontrollin e pjesës më të madhe të territorit, pas luftimeve me fraksione të rebelëve, duke përjashtuar një enklavë në veriperëndim të Idlibit dhe disa zona të kontrolluara nga forcat kurde. Përgjatë një dekade luftë, në të cilën kanë vdekur rreth 700 000 persona, regjimi është duke u përballur tani me 'Fitoren e Pirros'. Qytetet dhe qytezat kanë mbetur



OMAR HAJ KADOUR (AFP)

të shkatërruara, miliona persona janë pa shtëpi dhe po përballen me varfëri, si dhe ekonomia është në prag të shkatërrimit. Kritikët e sanksioneve kanë thënë se këto masa tentojnë t'i pengojnë përpjekjet për rindërtim të Sirisë dhe t'i lëndojnë civilët sirianë.

Ata, po ashtu, thonë se këto masa kanë qëllime joreale të largimit të Assadit nga pushteti, pasi forcat e tij kanë siguruar fitore ushtarake kundër opozitës së ndarë. "Nëntë vjet të luftës dhe vdekja e qindra mijëra personave nuk ka ndryshuar qasjen e Assadit dhe nuk e ka shtyrë atë të mendojë për moralin e pozitës së tij. A mund të arrijnë sanksionet atë që nuk

ka mundur lufta? Duket se ka pak mundësi", ka thënë Joshua Landis, drejtor i Qendrës për Studime të Lindjes së Mesme në Universitetin Oklahoma, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë". "Megjithatë, sanksionet dihet se do t'i dëmtojnë njerëzit e pafajshëm. Sirianët veçse kanë rënë në gjunjë. Ato vetëm do t'i shtyjnë edhe pak më poshtë", ka thënë ai.

Ambasadori rus në OKB, Vassily Nebenzia, ka thënë se ShBA-ja e ka konfirmuar se "qëllimi i këtyre masave është që të përmbysen autoritetet legjitime të Sirisë". Ambasadori kinez në OKB, Zhang Jun, ka thënë se "shtetet e ndjeshme sikurse Siria janë duke u përballur me pandeminë e koronavirusit, andaj vendosja e

sanksioneve shtesë është jonjerëzore dhe mund të shkaktojë katastrofa shtesë".

Hassan Nasrallah, lider i Hezbollahut, i ka përshkruar sanksionet si "armën e fundit të Amerikës", që synojnë ta përballin me uri popullin sirian. "Aleatët që i kanë qëndruar afër politikisht dhe ushtarakisht Sirisë nuk do ta braktisin atë në prag të luftës ekonomike dhe nuk do ta lejojnë rënien e saj", është zotuar Nasrallah.

Sanksionet pritet ta godasin edhe Libanin pjesërisht në kohën kur ky shtet po përballlet me krizë të pashembullt ekonomike.

Siria është rruga e vetme tokësore e Libanit për të kaluar në pjesën tjetër të botës arabe.

OBSH-ja do t'i përditësojë udhëzimet për Covid-19 pas 'rezultateve shpresëdhënëse' të një ilaçi



NJU JORK, 17 QERSHOR - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) do t'i përditësojë udhëzimet lidhur me trajtimin e koronavirusit pasi një studim gjeti se një steroid i lirë mund të ndihmojë që t'i shpëtojë të sëmurët me Covid-19. Studiuesit britanikë të Universitetit Oksford thanë se deksametazona që përdoret që prej viteve '60 për ta zvogëluar

inflamacionin për sëmundje të tilla si artriti - ul shkallën e vdekjes me rreth një të tretën në më shumë se 2 000 pacientë të sëmurë rëndë me Covid-19. "Ky është trajtimi i parë që shfaq uljen e vdekshmërisë të pacientët me Covid-19, të cilët trajtohen me oksigjen apo me ventilatorë", ka thënë drejtori i OBSH-së, Adhanom Ghebreyesus. Ndërkaq në një deklaratë të

OBSH-së theksohet koordinimi për analizat e të dhënave. "OBSH-ja do t'i koordinojë të gjitha analizat e të dhënave, me qëllim që të kemi një kuptim më të qartë të ndikimit të këtij ilaçi. Udhëzimet klinike të OBSH-së do të përditësohen me qëllim që të tregojnë se si ky ilaç duhet të përdoret për pacientët me Covid-19", thuhet në deklaratën e OBSH-së.

Pekini ndal udhëtimet pas rritjes së numrit të të infektuarve me Covid-19

PEKIN, 17 QERSHOR - Miliona persona në Pekin janë duke jetuar nën kushte të reja të kufizimit teksa vazhdon të rritet numri i rasteve të të infektuarve me koronavirus. Ky qytet ka raportuar për 31 raste të reja të mërkurën, duke e çuar numrin total në 137, vetëm në javën e kaluar. Përpara shpërthimit të ri, kryeqyteti kinez nuk pati regjistruar raste lokale të të

infektuarve për 57 ditë. Shpërthimi besohet se ka nisur në një treg të madh të ushqimit, që furnizon 80 për qind të qytetit me mish dhe perime. Të paktën 27 lagje janë klasifikuar me rrezik të mesëm dhe një lagje afër tregut, me rrezik të lartë. Më shumë se 1 200 fluturime janë anuluar, për dhe nga qyteti, si dhe shërbimet e trenave janë

kufizuar deri të paktën më 9 korrik. Mësimi nëpër shkolla fillore, të mesme dhe kolegje është pezulluar, derisa palestrat janë mbyllur. Megjithatë, rrugët janë të hapura dhe fabrikat mund të punojnë ende. Pas regjistrimit të mbi 80 000 rasteve të reja në fillim të muajit mars, Kina ka raportuar vetëm për 3 200 raste të reja që nga ajo kohë.



Wang Ren (AFP)

Recension për veprën e dr. sc. Salihe Salihu

“Sovraniteti dhe legjitimiteti i shtetit të Kosovës”



Prof. Dr. Fehari RAMADANI

Historia e Kosovës së fundshekullit XX karakterizohet nga ngjarje të shumta, të cilat sa janë të rëndësishme dhe të lavdishme, po aq janë të dhimbshme dhe të trishtueshme. Në kohën kur bota e civilizuar po kalonte procesin e globalizimit, të hapjes e afrimit midis popujve, të mënjanimet të ndasive dhe konflikteve, Kosova po përballëj me një luftë të tmerrshme, me gjenocid e spastrim etnik që ushtrohej nga pushtuesit e dhunshëm serbë. Një tablo e përgjithësuar në lidhje me këto krime çnjerëzore të kryera nga regjimi fashist serb i udhëhequr nga Slobodan Millosheviq na paraqitet në veprën “Sovraniteti dhe legjitimiteti i shtetit të Kosovës” i autores dr. Salihe Salihu.

Kjo vepër përmban informacione shumë të hollësishme për luftën e Kosovës, për krimet e kryera gjatë viteve 1998-1999, për intervenimin ushtarak të

NATO-s, për qeverisjen kalimtare, për procesin drejt pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës, për legjitimitetin e ndërhyrjes ushtarake të Aleancës Veri-atlantike dhe atë të pavarësisë së Kosovës.

Dr. Salihe Salihu me këtë vepër pasqyron politikën kolonizuese e shfarosëse që shteti serb zhvilloi në Kosovë për një periudhë gati njëshekullore. Autorja jep të dhëna të rëndësishme për vrasjet, masakrat, varret masive, dhunimet dhe personat e pagjetur, burgosjet e deri te dëbimi e deportimi i popullsisë shqiptare nga Kosova. Ajo prezanton të dhëna mbi shkatërrimet e kryera, plaçkitjet, djegiet dhe traumat e shkaktuara nga pushtuesit. Gjithashtu, rëndësi i është kushtuar luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndihmës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë e deri në kthimin e popullsisë shqiptare në vendlindjen e vet.

Ky studim, me strukturë të logjishme e të qëndrueshme, është rezultat i një pune të gjatë kërkimore e shkencore të autores. Ajo studimin e saj e nis nga studimet paraprake në lidhje me këtë çështje, të cilave autorja u qaset në mënyrë shkencore e kritike. Hulumtimin e saj, dr. Salihe

Salihu e ka thelluar, pasuruar dhe ndërtuar, duke u mbështetur në burime të shumta si dhe literaturë shumë të pasur. Shfrytëzimi i burimeve të ndryshme, vendore e të huaja e bëjnë këtë vepër të rezistueshme ndaj çdo kritike shkencore. Me këtë vepër, autorja, pasi hulumtoi, analizoi, vlerësoi dhe sistematizoi gjithë ato materiale, arriti të nxjerrë në dritë një mori të dhënash e ngjarjesh, të cilat deri më tani ishin fare pak të njohura ose dhe të panjohura, jo vetëm për opinionin e gjerë, por, edhe për qarqet përkatëse shkencore.

Vlera e këtyre botimeve është e një rëndësie të veçantë për faktin se ato na ofrojnë informacione shumë të detajuara për zhvillimin e luftës, rolin e NATO-s, procesin e shtetndërtimit në Kosovë dhe legjitimitetin e saj. Rëndësia e kësaj vepre është edhe më e madhe po të kemi parasysh faktin, se ajo do të jenë një burim i çmueshëm për gjeneratat e ardhshme, të cilat do të interesohen për historinë e Kosovës në veçanti dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Gjithashtu, vlerat e këtij libri rriten edhe më tepër sepse nëpërmjet tij prezantohen krimet e kryera nga Serbia në Kosovë dhe ligjshmëria e pavarësimit të Kosovës. Nëpërmjet kësaj vepre opinionin i gjerë do të njihet me gjenocidin

shtetëror që Qeveria e Serbisë ushtroi mbi popullsinë civile shqiptare, që ata të mund të bëjnë dallimin e midis kriminelëve dhe viktimave.

Autorja ka argumentuar se pavarësia e Kosovës ishte e ligjshme dhe se ajo nuk përbënte shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Kosova iu aneksua dhunshëm Serbisë. Gjatë historisë gati njëshekullore shqiptarët luftuan për të drejta kombëtare dhe kurrë nuk u pajtuan me pushtimin serb. E drejta për vetëvendosje asnjëherë nuk u praktikua në Kosovë.

Kosova ishte njësi e veçantë dhe njëkohësisht pjesë përbërëse e Federatës Jugosllave, sipas Kushtetutës së vitit 1974. Ajo kishte përfaqësuesit e saj në të gjitha organet e shtetërore dhe për rrjedhojë ashtu si pjesët e tjera të federatës edhe Kosova kishte të drejtën e shkëputjes. Suprimimi i dhunshëm i Kushtetutës, në vitin 1989, përbën arsye shtesë për shkëputje. Botimi i veprave dhe artikujve shkencorë të këtyre janë dëshmia më e mirë për të argumentuar se kush ka kryer krime, gjenocid, dhunime, tortura dhe spastrim etnik në Kosovë. Përkthimi dhe botimi i tyre në gjuhë të huaja do të përbënte një kontribut të çmueshëm për pasqyrimin e të vërtetës për shqiptarët dhe

Kosovën para opinionit ndërkombëtar.

Për dr. Salihe Salihun botimi i kësaj vepre nuk është fillimi i veprimtarisë së saj shkencore. Në punën e saj shkencore dhe profesionale ajo ka botuar edhe vepra të tjera dhe disa artikuj shkencorë, nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare, të drejtave të njeriut etj., të publikuar brenda dhe jashtë vendit. Me punën dhe angazhimin e saj autorja e kësaj vepre po e dëshmon veten si studiuese serioze.

Me një stil shumë të kuptueshëm dhe të rrjedhshëm autorja pasqyron gjithë zhvillimin e luftës, të ndërhyrjes së NATO-s, të procesit të pavarësisë dhe të ligjshmërisë së tyre. Mënyra e strukturimit dhe e hartimit të veprës në fjalë, stili i përshtatshëm dhe gjuha e pastër që përdor autorja, rrisin edhe më tepër vlerat e saj.

Libri i dr. Salihe Salihut “Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës” duhet të shërbej si një literaturë e domosdoshme për studentët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të Historisë dhe të degëve të tjera. Gjithashtu, kjo vepër do t’u shërbej studiuesve por dhe opinionit të gjerë, i cili ka interes të njihet me Luftën e Kosovës dhe legjitimitetin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s dhe të pavarësisë së Kosovës.

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijjnë për herë të parë në formatin digjital, falas

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijjnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Nisur nga mungesa e shumë veprave të digjitalizuara, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në kuadër të projektit “Diaspora për Zhvillim” sjell Platformën Digjitale të Veprave Shqiptare.

Platforma është krijuar me qëllim gjallërimin dhe promovimin e kujtesës kolektive kulturore të komunitetit të Diasporës shqiptare si dhe krijimin e kushteve dhe nxitjen e angazhimit kulturor të anë-

tarëve të Diasporës shqiptare.

Pjesë e platformës “Digjitalizimi i Veprave Shqiptare” do të jenë 100 vepra të një game të gjerë zhanresh nga autorë të Rilindjes Kombëtare, të letërsisë bashkëkohore shqiptare si dhe vepra të letërsisë për fëmijë.

Digjitalizimit të veprave shqiptare i kushtohet një rëndësi e veçantë në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, si një instrument për përcjelljen dhe ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore e kulturore shqipe në Diasporë.

Veprat e para të digjitalizuara mund t’i gjeni në linkun: <https://adld.al/>

DIGJITALIZIMI I VEPRAVE SHQIPTARE
PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË GJUHËSORE E KULTURORE SHQIPE NË DIASPORËN
DHE JASHTË SHQIPËRISË.

KRYEFAQJA | RRETH NESH | VEPA | FAQ | KONTAKT | LLOGARIA IME

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS


E rrallë

Firma e njohur mbyll 1 200 dyqane në të gjithë botën

Pandemia duket se po rikthehet sërish në ato vende të botës ku sapo kishte nisur rihapja dhe kthimi në normalitet. Për këtë arsye, firma e famshme e robave dhe aksesoreve "Zara" ka vendosur t'i mbyllë 1 200 dyqane nga 7 000 që zotëron gjithsej. Mbylljet do të bëhen kryesisht në Evropë dhe Azi, aty ku shfaqet rreziku më i madh nga pandemia. Disa mendojnë se kjo mund të jetë edhe një strategji e firmës për ta shtuar numrin e shitjeve online, por kjo e fundit nuk është konfirmuar ende.



FOTO E DITES



Pandemia, aeroplanët e parkuar të 'Thai Airways' në aeroportin Suvarnabhumi në Bangkok të Tajlandës /Reuters/

E jashtëzakonshme

Një qytetar në Vjenë lëshon gazra para policisë, dënohet 500 euro

Një burrë në Vjenë është gjobitur me 500 euro për një lëshim të zhurmshëm ajri para policisë, në një vendim që tashmë policia e kryeqytetit austriak po përpiqet ta mbrojë me çdo argument. E përditshmja "Osterreich" raporton se incidenti ndodhi më 5 qershor kur shkelësi u

gjobit për shkelje të normave morale publike. Policia e qytetit shkruante në një koment se "sigurisht askush nuk denoncohet se aksidentalisht i shpëton një". Por ata shtuan se njeriu po sillet në mënyrë provokuese dhe jobashkëpunuese me oficerët para incidentit.



BARSOLETA E DITËS



MARTESA E DYTË
 Dy miq takohen me njëri-tjetrin pas shumë kohësh. Njëri, duke e ditur se tjetri ishte martuar sërish, e pyet: - Aman, më fal për kuriozitetin, po kam kohë që e vras mendjen. Mirë që të vdiq gruaja, po pse u martove së dyti me motrën e saj? - Eh... ty mund të ta them të vërtetën! Nuk pata kurajë t'ia nisja nga e para, me një vjehërr tjetër!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

U dogj në 85% të trupit 53-vjeçares në garë për çmimin 'Portrait of Humanity 2020'

53-vjeçarja Carol Mayer nga Queensland, Australi, pësoi djegie në rreth 85 përqind të trupit gjatë një zjarri që përfshiu shtëpinë e saj dy dekada më parë. 'Ish-mbretëresha e bukurisë', për të cilën u tha që kishte vetëm 50 përqind mundësi për të mbijetuar pas incidentit, ka pozuar disa foto të veçanta. Fotot nudo të shkrepura nga fotografi me origjinë nga Londër, Brian Cassey, dhe që janë titulluar 'Skin The Skin I'm In' janë listuar në tabelën për çmimin Portreti 'Humanity 2020'. Carol dhe djali i saj i mbijetuan flakës së tmerrshme, por Carol

mori plagë që i ndryshuan jetën. Tani, 53 vjeçarja, e cilësuar edhe si 'ish-mbretëresha e bukurisë thotë': Me djegiet është e vështirë fizikisht dhe mendë-



isht për çdo njeri që të kalojë. Por nëse e keni atë frymë të vërtetë luftarake, atë që unë kam, kjo është ajo që më ka ripërtëritur, mirësjellje dhe vendosmëri.



 <p>DASHI Uleni pak ritmin në punë. Edhe nëse të tjerët synojnë të dalin para jush, duhet të mendoni më shumë për veten tuaj.</p>	 <p>DEMI Lidhja me njerëzit e tjerë do të jetë më e lehtë se kurrë më parë për ju tani. Ju keni një aftësi të fortë për ta dëgjuar nëntekstin e çfarëdo gjëje.</p>	 <p>BINJAKËT Nëse prej kohësh keni pritur që një grup njerëzish të caktuar të mendojë njësoj si ju, do të keni një mundësi të përsosur.</p>	 <p>GAFORRJA Dilni nga rutina juaj dhe angazhohuni në aktivitete që mund t'ju bëjnë jetën më interesante. Monotonia nuk sjell asgjë të mirë te ju.</p>	 <p>LUANI Çfarëdo stresi që keni ndër kohët e fundit do t'ju hiqet nga shpatullat përkohësisht nesër. Ka një fluks të ri energjie në jetën tuaj që nxitet nga misteri.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Është koha për ta kërkuar ndihmën që ju nevojitet në punë, në shkollë, apo edhe në dietën tuaj. Ka njerëz që mund t'ju ndihmojnë veçanërisht në aspektin profesional.</p>
 <p>PESHORJA Kjo është një kohë e mirë për të rezikuar në fushë e romancës dhe të jeni pak më të guximshëm për ndonjë filtrim. Në punë gjërat duken të qëndrueshme.</p>	 <p>AKREPI Bëjini vetes një nder dhe gëlltiteni frikën, krenarinë ose çfarëdo tjetër që mund të t'ju pengojë.</p>	 <p>SHIGJETARI Aftësitë tuaja mendore janë të mprehta dhe energjia juaj fizike po rritet. Ky kombinim i pamposhtur është forca e blinduar perfekte për çfarëdo beteje.</p>	 <p>BRICJAPI Gjëra të mëdha do të ndodhin, edhe pse ju nuk jeni shumë të përgatitur për këtë. Aftësitë tuaja organizative gjithmonë ju kanë ndihmuar.</p>	 <p>UJORI Energjia juaj është e përshtatshme për një qasje vlerësuese ndaj asaj që po ndodh dhe çfarë do të ndodhë së shpejti.</p>	 <p>PESHQIT Mund të merrni lajme të mira sa i përket aspektit ekonomik. Një investim që mund të keni kryer shumë kohë më parë mund të nisë të japë rezultate.</p>

Alena Seredova, dalja e parë me vajzën e porsalindur Vivienne Charlotte



Lumturia i lexohet në sytë e tyre. Alena Seredova dhe Alessandro Nasi që kur janë bërë prindër të Vivienne Charlotte duken shumë të lumtur. Ajo është nënë e dy djemve, David Lee dhe Louis Thomas, që i ka


nga martesja me Gigi Buffon, por kjo vajzë që ka ardhur në jetë disa javë më parë, duket se ka sjellë një lumturi të re në shtëpi. Alena ka postuar foto të së porsalindurës, duke treguar të gjithë krenarinë e saj.

Megan Fox del publikisht me Machine Gun Kelly



Megan Fox është përfolur së fundmi në mediat rozë për shkak të ndarjes së saj nga bashkëshorti Brian Austin Green. Ditë më parë aktorja e njohur u shfaq së bashku me reperin Machine Gun Kelly, për të cilët kanë lindur dyshime se mund të kishin filluar një lidhje dashurie, shkruan "Mirror". Kjo vjen pasi flitej se Megan dhe Brian po jetojnë të ndarë, pas 10 vjetësh të martuar.

Brian fillimisht kishte insistuar se aktorja ka shoqëri me Kelly, duke mohuar në këtë mënyrë se ajo është duke e tradhtuar. Vetëm disa javë më pas ajo është parë me reperin në një mbrëmje në Los Anxhelos, duke i shtuar kështu takimet me të. Në imazhet e ndara dyshja është fotografuar dorë për dorë teksa shkëmbejnë puthje edhe në makinë.



Dua Lipa dhe Anwar Hadid festojnë 365 ditë dashurie

"Nuk ka gjë më të ëmbël se 365 ditë pranë teje". Dua Lipa feston vitin e parë të fejesës me Anwar Hadid (vël-lai i modeleve Gigi dhe Bella) me një foto të ëmbël ku shfaqen të dy së bashku në shtrat dhe një galeri fotosh që dokumenton etapat e historisë së tyre të dashurisë.

Këngëtarja, 23 vjeçe, ylli në muzikë dhe modeli 20-vjeçar janë njohur në fund të qershorit të 2019-s dhe kanë

zyrtarizuar lidhjen e tyre në publik në MTV EMA 2019, pastaj në American Music Awards 2019, kanë pozuar të dy së bashku në tapetin e kuq. Dashuria e tyre është forcuar më shumë gjatë periudhës së lockdown ku të dy kanë qëndruar së bashku në Londër. Këngëtarja është zbavitur duke ndryshuar ngjyrën e flokëve dhe duke postuar vazhdimisht foto për fansat e saj.

Vdes në moshën 28-vjeçare këngëtari koreano-jugor



Këngëtari nga Koreja e Jugut, emri i vërtetë i të cilit është Kim Jeonghwan, i cili ishte anëtar i grupit të djemve TST (i njohur dikur si Top Secret), ka vdekur në moshën 28-vjeçare, konfirmuan

të mërkurën gazetat koreane. Shkaku i vdekjes së tij nuk është zbuluar ende. Trupi i tij po mbahet në Spitalin Severance në qytetin Sinchon dhe ai do të transferohet në një varrezë në Yongin më 18 qershor.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ballkani dhe Prishtina, në finale të Kupës

Ballkani ose Prishtina do ta përfaqësojnë Kosovën në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës pasi të dyja këto skuadra janë kualifikuar në finale të Kupës. Skuadra fituese siguron daljen në Evropë



Bekteshi. Drenica, pas tre golave të pranuar, u lëshua më shumë në sulm dhe arriti të shënojë dy

gola me anë të Flamur Mulecit dhe Kerimit, por që ishin të pamjaftueshëm për ta bërë përmbysjen e rezultatit. Fitues

në fuqi i Kupës është Feronikeli, kurse finalja në mes të Ballkanit dhe Prishtinës do të zhvillohet më 29 korrik.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Skuadra e Ballkanit nga Suhareka ka arritur që të kualifikohet në finale të Kupës së Kosovës pasi ka luajtur baras me Feronikelin në ndeshjen kthyesë që është zhvilluar të mërkurën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas (1-1). Ndeshja e parë kishte përfunduar 0-0, por skuadra e Ismet Munishit kualifikohet falë golit të shënuar si mysafir. Të parët në epërsi kaluan mysafirët në minutën e 27, kur Mirlind Daku shënoi me kokë për rezultatin 0-1. Rastet e tjera nuk munguan në pjesën e parë, por gola të tjerë të shënuara nuk pati. Në pjesën e dytë, Feronikeli u rikthye në lojë me golin e Van Dave Harmon, por

edhe përkundër përpjekjeve për ta shënuar golin e fitores, skuadra e Afrim Tovërlanit nuk pati sukses. Në finale të Kupës, Ballkani do të përballlet me skuadrën e Prishtinës. Kjo e fundit e fitoi edhe ndeshjen kthyesë të gjysmëfinale kundër Drenicës (2-3), kurse rezultati i përgjithshëm nga të dyja ndeshjet është 6-2. Ky është një sukses i madh për klubin kryeqytetas që do të mundohet ta fitojë trofeun e Kupës, i cili mundëson edhe pjesëmarrjen në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës. Në pjesën e parë për mysafirët shënuan Leonit Abazi nga gjuajtja e lirë dhe Endrit Krasniqi nga penalltia, kurse në pjesën e dytë Prishtina sërish shënoi gol nga penalltia, por kësaj radhe golashënues ishte mbrojtësi Leotrim

Ramadani: Synojmë kualifikimin historik në 'Euro 2022'



PRISHTINË, 17 QERSHOR - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, ka analizuar shortin e kualifikimeve për "Euro 2022" që është tërhequr dje. Kosova është në grupin e tetë së bashku me Suedinë, Malin e Zi dhe Rumaninë. Sipas Ramadani, Kosova është para një sfide të vështirë, por jo të pamundshme. "Rezultatet pozitive në kualifikimet e kaluara kanë bërë që tani të marrim pjesë në raundin e dytë kualifikues, pa pasur nevojë për paraqitje në raundet parakualifikuese. Realisht kemi prituri këtë nivel të

kundërshtarëve", ka thënë Ramadani. Ai ka konfirmuar se synim mbetet kualifikimi historik. "Synimi është kualifikimi në 'Euro 2022'. Detyra jonë është t'i fokusojmë të gjitha energjitë tona në këtë drejtim për ta realizuar këtë synim. Suedia është favorite në këtë grup dhe ka shanset më të mëdha për ta udhëhequr grupin. Mali i Zi dhe Rumania janë super ekipe me përvojë të madhe ndërkombëtare, por nuk e kanë konsistencën e Suedisë. Kjo është dëshmuar në kualifikimet e fundit për Evropian. Befasitë

janë të mundshme, sidomos para publikut vendor dhe sidomos për ne. Rumania dështoi të kualifikohet në 'Euro 2020', kurse Mali i Zi u kualifikua me dy humbje dhe një barazim shokues ndaj Ishujve Faroe në Podgoricë", ka shtuar Ramadani. Nën udhëheqjen e Ramadani, "dardanët" kanë arritur suksese dhe kanë bërë hapa të rëndësishëm para. Hap tjetër para synohet në kualifikimet e ardhshme. "20 nga 32 ekipet kombëtare kalojnë në kampionat evropian. Ne do të përpiqemi të jemi një nga këto 20", ka deklaruar Ramadani.

Më 8 tetor zhvillohet ndeshja Maqedoni - Kosovë

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Ndeshja në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës do të luhet më 8 tetor në Shkup, e vlefshme për gjysmëfinalen e fazës "play-off" të Ligës së Kombeve.

Shtëpia e futbollit evropian në mbledhjen e mbajtur sot ka dalë me vendim që ndeshjet e Ligës së Kombeve, që do ta kompletin 24 skuadra pjesëmarrëse në Kampionatin

Evropian të vitit të ardhshëm, do të luhet në tetor, kurse finalët në nëntor. Përfaqësuesja e Kosovës do të përballlet me Maqedoninë e Veriut në Shkup më 14 tetor,

ndeshja e cila parashihet të luhet pa tifozë. Në rast fitoreje, "dardanët" presin fituesin e ndeshjes Bjellorusi - Gjeorgji për të luajtur në finalen e madhe më 19 nëntor.



Finalja e Ligës së Kampionëve zhvillohet në Portugali

NION, 17 QERSHOR - Liga e Kampionëve do të rifillojë më 7 gusht. Pas mbledhjes së sotme të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s u vendos që kompeticioni të vazhdojë me

fazën e "tetë finalistëve". Të gjitha takimet e kësaj faze do të luhen në kryeqytetin e Portugalisë, Lisbonë, në periudhën 12-23 gusht. Të gjitha takimet e fazës çerekfinale

dhe gjysmëfinale do të luhen me vetëm një ndeshje. Finalja e këtij edicioni nuk do të zhvillohet në Stamboll ashtu siç ishte planifikuar përpara këtij sezoni, por në Lisbonë.

Ndeshjet e mbetura të fazës 1/16-ave do të luhen nga 7-8 gusht dhe është lënë në dorën e klubeve nëse do të luajnë në stadiumet respektive apo në Lisbonë.



Fetahu njofton FIBA Europen për Ligën Mbarëkombëtare me Shqipërinë

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, ka marrë pjesë në videokonferencën e dytë të organizuar nga FIBA Evropë. Në këtë takim morën pjesë presidenti i FIBA Evropës, Turgay Demirel, sekretari i Përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis, tre zëvendës presidentët e FIBA Evropës, drejtori ekzekutiv i FIBA Evropës, Kamil Novak dhe përfaqësues të federatave të tjera nacionale të Evropës. Në këtë takim është diskutuar mbi gjendjen në vendet e ndryshme dhe masave të sigurisë dhe shëndetit, të cilat janë të zbatueshme për federatat pjesëmarrëse. U inkurajua shfrytëzimi i platformës së FIBA-s për këmbim të informatave dhe zhvillimi i aktiviteteve jashtë sallave, në veçanti 3x3, në momentin e parë që kjo të lejohet nga autoritetet në Kosovë. "Duke falënderuar FIBA-n dhe FIBA Evropën për përkrahjen e madhe të dhënë në procesin e planifikimit strategjik, si procesi më madhor për basketbollin e Kosovës në vitet e fundit, kryetari Arben Fetahu njoftoi për të gjitha zhvillimet e fundit



dhe planin e kthimit në terrene sportive, natyrisht në bazë të udhëzimeve të FIBA-s dhe autoriteteve vendore", thuhet në njoftimin e FBK-së. Sipas njoftimit të Federatës së Basketbollit, kryetari Arben Fetahu e njoftoi FIBA Evropën për procesin e përgatitjes për

Ligën Mbarëkombëtare me Shqipërinë, punën e bërë bashkë me SHTBK-në për edukimin dhe licencimin e trajnerëve, kampet e zhvillimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe kampet për përfaqësueset e Kosovës që janë planifikuar për muajin gusht.

Ndeshjet e Ligës së Evropës zhvillohen në Gjermani

NION, 17 QERSHOR - Ndryshe nga Liga e Kampionëve, ndeshjet e Ligës së Evropës do të luhen në katër qytete të ndryshme të Gjermanisë: Koln, Duisburg, Dyseldorf dhe Gelserskishen. Ky kompeticion do të rifillojë më 5 gusht. Ky ishte vendimi i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s për Ligën e Evropës. Sipas programit, më 5-6 gusht do të zhvillohen ndeshjet e fazës së 1/16-ave. Çerekfinalet do të luhen më 10-11 gusht në 4 qytetet e sipërpërmendura. Gjysmëfinalet do të luhen më 16-17 gusht dhe finalja më 21 gusht në Koln, edhe pse ishte vendosur para fillimit të sezonit të luhej në Gdansk të Polonisë. Takimet nga faza çerekfinale deri në fund do të luhen me një



ndeshje të vetme. Ndeshjet e fazës 1/16-ve Inter-Getafe dhe Roma-Sevilla do të zhvillohen me vetëm një ndeshje. Nga ana tjetër, UEFA përcaktoi dhe ku do të zhvillohen finalet e 3

edicioneve të ardhshme të Ligës së Evropës. Gdansk (Poloni) pret finalen e 2021-shit, Sevilla (Spanjë) do ta mbajë finalen e 2022-shit, ndërsa në Hungari do të zhvillohet finalja e 2023-shit.

SHKURT

Bottas: Jam gati të dueloj ndaj Hamiltonit

Edhe pse ka qëndruar tre muaj pushim për shkak të koronavirusit, piloti finlandez Valtteri Bottas shprehet se është gati për nisjen e sezonit 2020 në Formula 1. Deri më tani janë zyrtarizuar 8 gara, por në total mund të jenë 15-18 të tilla. Bottas ka kryer një stërvitje të veçantë gjatë kësaj periudhe dhe është gati të duelojë ndaj Lewis Hamiltonit. "Para 3-4 javësh bëra një test fizik dhe kam arritur rezultatet më të mira në jetën time. Kjo ndodhi pasi kam pasur shumë muaj në dispozicion për të qenë në formën e duhur fizike. Kam shumë besim dhe kam shumë shanse se zakonisht", ka thënë Bottas, pilot i Mercedes. "Falë këtij pushimi të gjatë kam qenë sistematik në stërvitje. Do të jetë një sezon special, i veçantë, pasi do të jetë më i shkurtër se zakonisht. Çdo gabim do të kushtojë më shumë se herët e tjera, pasi nuk ke shumë kohë për të rikuperuar", ka shtuar Bottas.

Silva qëndron te City deri në fund të sezonit

Kontrata e David Silvas me Manchester City skadon më 30 qershor, por prej kohësh mesfushori spanjoll ka deklaruar se do të largohet nga skuadra angleze. "Edhe pse kontrata e tij përfundon pas dy javësh, Davidi do të qëndrojë me ne deri në fund të këtij sezoni. Klubi dhe lojtari do të gjejnë një marrëveshje për ta mbyllur këtë çështje. Kemi nevojë për një kampion si ai", ka thënë Guardiola.

Unitedi, gati ta transferojë Willianin

Futbollisti i Chelseat, Willian, do të largohet nga kjo skuadër pas plot shtatë vjetësh. Kontrata e brazilianit përfundon më 30 qershor dhe ai ka bërë të qartë se nuk dëshiron që ta rinovojë. Interesim për shërbimet e Willianit ka treguar Manchester Unitedi. Klubi nga "Old Trafford" ka filluar operacionin e transferimit të lojtarit brazilian, duke i ofruar kontratë trivjeçare me pagë të majme prej 7-8 milionë eurosh në sezon.

Lewandowski synon 'Topin e Artë'

Robert Lewandowski është duke zhvilluar një nga sezonet më të mira me skuadrën e Bayern Munchenit. Polaku është pranë shpalljes si golashënuesi më i mirë në Bundesligë. 31 gola në 32 javë për sulmuesin "bavarez", ëndrra e të cilit është ta fitojë Ligën e Kampionëve me gjermanët dhe "Topin e Artë". Ndaj Werder Bremenit polaku shënoi golin e vetëm të takimit duke i dhënë Bayernit titullin e 8-të radhazi. "Në vitin që shkoi isha pjesë e ceremonisë së 'Topit të Artë', ishte një ndjesi e mirë të isha midis më të mirëve. Të shohim, unë gjithmonë mendohem të jap më të mirën time për të shënuar sa më shumë dhe fituar trofe. Por të gjithë e dimë që të fitosh një trofe të tillë duhet të kesh një koleksion të madh kupash. Nuk është se jam duke menduar shumë për 'Topin e Artë', por në jetë mendoj se gjithçka është e mundur nëse nuk dorëzohesh kurrë", ka shtuar Lewandowski.

Santosi rinovon kontratën me Portugalinë

Fernando Santos do të mbetet në krye të Portugalisë, kombëtare që e shpalli kampione Evropë në vitin 2016. Federata portugeze ka zyrtarizuar rinovimin e kontratës me trajnerin 65-vjeçar deri në përfundim të "Euro 2024". Me shtyrjen e "Euro 2020" për në vitin 2021, Fernando Santos do të jetë në krye të Portugalisë në Evropianin e vitit të ardhshëm në Botërorin Katar 2022 nëse siguron kualifikimin dhe në "Euro 2024" gjithmonë në rast se kualifikohet. "Është privilegj për mua dhe stafin tim teknik ta vazhdojmë këtë projekt", u shpreh Santos.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hulumtimin dhe shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Vallaç komuna e Zveçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.07.2020 në ora 11:30 në hapësirat e restorant "Vidovdan" në Grabovac komuna e Zveçanit do të organizohet debat publik nga kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hulumtimin dhe shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Vallaç komuna e Zveçanit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn, Fusha e Pejës -Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë, shpall Konkurs publik për këto vende pune:

KONKURS

Pozita: PUNËTORI FIZIKË - / NË MBLEDHJEN E HEDHURINAVE (3)

Vendi i punës: Istog (1 pozita)

Vendi i punës: Pejë (2 pozita)

Punëtori ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
2. Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontejnerëve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesese nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdese.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit dhe Eprorit
6. Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimi:

- Shkolla e mesme-
- te ketë përvojë pune.
- Aftësia të mir komunikimi

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A, Rr. Xhem Sadrija, pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e aplikimit nga 18.06.2020 deri me 06.07.2020 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e rërës dhe zhavorrit në Sërboc komuna e Zveçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Vidovdan" në Grabovac komuna Zveçanit do të organizohet debat publik nga kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e rërës dhe zhavorrit në Sërboc komuna e Zveçanit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Bashkëpunëtor Profesional për Promovimin e Turizmit Kulturor
Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor Ferizaj
Kategoria funksionale: Koeficienti : 7
Numri i referencës: 10/2020
I përgjigjet: Drejtorit të QRTK Ferizaj
Vendi: Ferizaj

Lloji i kontratës: "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të QRTK Ferizaj, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve në fushën e turizmit kulturor;
- Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën e turizmit kulturor, në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Kryen detyrat në fushën e turizmit, me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
- Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
- Merr pjesë në grupe punuese në fushën e turizmit kur kërkohet një gjë e tillë.
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
- Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare, në shkencat shoqërore, në drejtimet juridik, ekonomik, nga fusha e artit, kulturës, gjuhe dhe letërsi shqipe, gazetari, minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

Procedurat e konkurrit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 8 (tetë) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 25.06.2020

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereza" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës". Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Br. 03/L-149, i uredbe Br. 02/2010, o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Profesionalni Saradnik za Promovisanje Kulturnog Turizma
Institucija: Regionalni Centar za Kulturnu Baštinu- Uroševac
Funkcionalna kategorija: Koeficientat : 7
Broj referencije: 10/2020
Odgovorani je: Direktor Regionalnog Centra za Kulturnu Baštinu- Uroševac

Mesto: Uroševac

Vrsta Ugovora: „Sporazum o posebnim uslugama“ (Vremenski rok 6 meseci)

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora Centra za Kulturnu Baštinu- Uroševac

izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

- Razvija i postiže saglasnost za planove rada i rokove sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom za sprovođenje dotičnih usluga iz oblasti kulturnog turizma;
- Izvršava specializovane zadatke, prema zahtevu, iz oblasti kulturnog turizma, u podudarnosti sa dotičnim zakonom, pravilnicima, politikama i procecurama, unutar određenih vremenskih rokova;
- Izvršava zadatke iz oblasti turizma, sa jednim razložnim stepenom nezavisnosti, sa povremenim nadzorom i uputstvima;
- Vrši istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju uputstava za razmatranje od najviših nivoa;
- Učestvuje u radnim grupama iz specifične profesionalne oblasti. Kada se tako nešto zahteva.
- Komunicira unutar institucije i van nje za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti zajedničkog interesa;
- Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa, u vezi prihvaćenih planova rada;
- Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične, profesionalne oblasti, koji se razložno mogu zahtevati s vremena na vreme.

Zahtevao obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

- Duboko poznavanje specifične, profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
- Poznavanje zakona i pravilnika koji se sprovode;
- Sposobnost u komuniciranju za planiranje rada, eventualna koordinacija sa radnim osobljem;
- Sposobnost za istraživanje, analitiku, procenjivanje i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta;
- Sposobnost na kompjuteru, u aplikovanju programa (Word, Excel, Power Point, Access);
- Univerzitetska diploma, društvene nauke, na pravcima; prava, ekonomije, umetnosti, kulture, albanski jezik i književnost, novinarstvo, minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na određeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 8 (osam) dana .

Zadnji datum za aplikovanje je: 25.06.2020

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

Predaja zahteva: Aplikacija se uzima i predaje u kancelariji Broj 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta Trg "Majka Tereza", Br. 44. Za dodatne informacije, kontaktirajte broj 038211449 i 038 211921 (ili na web-stranici <http://www.mkrs-ks.org/>). „Civilna Usluga Kosova nudi jednaku mogućnost zapošljavanja za sve državljane Kosova i prihvata aplikacije od svih soba muškog roda, ženskog roda i svih komuniteta Kosova. Ne-većinski Komuniteti i njihovi članovi imaju pravo na pravo i proporcionalno predstavlanje u organima civilnih usluga javne administracije, centralne i lokalne, kao što je specifikovano u članu 11, paragrafu 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnim Uslugama Kosova. Zahtevi poslati nakon zadnjeg datuma kao i nekompletirani zahtevi, neće se primiti. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktirajte se samo kandidati koji su odabrani u užoj listi.



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
Одељење за образовање и културу
KOMUNA E GRAÇANICËS
Departamenti i Arsimit dhe Kulturës
Грачаница/ Graçanicë

На основу члана 8. став 1. Закона о раду (Бр.03/3-212) и члана 4. Административног упутства (МРСЗ) Бр.07/2017 за регулисање процедура конкурса у јавном сектору, Одељење за образовање и културу општине Грачаница дана 18.06.2020.године, објављује:

Нë базë të nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit të Punës (nr. 03/L-212), dhe të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkurimit në sektorin publik, Departamenti i Arsimit dhe Kulturës së Komunës së Graçanicës, më datën 18.06.2020. shpall këtë:

ЈАВНИ КОНКУРС KONKURS PUBLIK

1. Назив радног места: Помоћно особље

Услови:

Завршена средња школа

Број радних часова: 40 неделно

Месечна бруто плата: 272,88 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: 3 месеца, уз могућност продужења.

1. Titulli i vendit të punës: Staf i ndihmës

Кухетет:

-Тë ketë kryer shkollën e mesme

Numri i orëve: 40 orë në javë

Paга mujore bruto: 272,88 €

Numri i ekzekutuesve: 1

Период е пëрфундмит të kontratës: (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

Кандидат мора бити: пунолетан, пословно способан и да није осуђиван за кривична дела која га чине неподобним за вршење посла и за која се изриче казна затвора у трајању од најмање 6 месеци.

Кандидат дует të jetë: madhor, i aftë për punë dhe që të mos jetë i dënuar për vepra penale, të cilat e bëjnë atë të papërshtatshëm për kryerjen e punës dhe për të cilat mund t'i shqiptohet dënimi me burg në një kohëzgjatje më pak se 6 muaj.

Сваки кандидат уз апликацију прилаже: фотокопију важеће личне карте, оверену фотокопију дипломе, доказ о радном искуству, уверење да није под истрагом.

Secili kandidat duhet ta paraqet së bashku me aplikacion: kopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, fotokopjen e verifikuar të diplomës, dëshminë e përvojës së punës, vërtetimin që nuk është nën hetim.

Конкурс остаје отворен 15 дана од дана објављивања.

Апликације се могу преузети и поднети сваког радног дана у општини Грачаница у периоду од 08:00 до 16:00 часова.

Кандидати могу своје апликације да подносе у периоду од 18.06.2020. до 02.07.2020.године.

Конкурс и метет i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Апликационин мунд та мerrni dhe та dorëzoni çdo ditë pune në Komunën e Graçanicës prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

Кандидатët мунд t'i dorëzojnë апликационет e tyre në një periudhë prej 18.06.2020. deri më 02.07.2020

Напомена: Неблаговремена и некомплетна документација неће бити разматрана.

Вëреитје: Документациони i dorëzuar pas afatit të fundit dhe i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.

Директор:
(м.п.)

Бранкица Нишић

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kujtim Domuzeti shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Butrint Thaqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Fidan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat shf " Arsimit Maliqaj " Poslisht.

► Refki Gjembali shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Ali Maqiteva shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

